



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 35 (827682)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 4 Shtator 2020

## Zv/ministri Petro Koçi në Kumanovë (kazerma "Boro Menkov") Maqedonia e Veriut



### Koçi: Brigada (SEEBRIG) promovon bashkëpunim dhe stabilitet rajonal

Zoti Petri Koçi, zv/ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e Kryetarit aktual të SEDM-it, mori pjesë në Kumanovë (kazerma "Boro Menkov") të Maqedonisë së Veriut, në një ceremoni solemne, organizuar më 26 gusht 2020, me rastin e vendosjes në këtë vend (me rotacion) të Ko-

mandës së Brigadës së Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) për vitet 2020-2026, ndërrimin e komandantëve të SEEBRIG dhe festimit të 21-Vjetorit të Komandës së SEEBRIG. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm krerët më të lartë politikë dhe ushtarakë të Maqedonisë së Veriut si: Presidenti i Republikës... >>> faqe 4

## ME RASTIN E 100 VJETORIT TË LUFTËS SË VLORËS

Historianit ushtarak Prof.Ass.Dr.Bernad Zotaj, i jepet titulli "Mjeshtër i Madh"



>>> faqe 7

## Akademia e Forcave të Armatosura

# Përfundon raundi i I-rë i aplikimit, dalin fituesit, më 19-21 shtator raundi i II-të

Në Akademinë e Forcave të Armatosura, për programin 3 vjeçar të studimeve në fushën e 'Shkencës Ushtarake', pas tre raundeve, do të ulen në auditorë 60 studentë ushtarakë, brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura >>> faqe 3



## Yuri Kim publikon videon

### Bombarduesi amerikan B-52 fluturoi mbi qiellin shqiptar

Bombarduesi amerikan B-52 ka fluturuar ditën e premte, më 28 gusht 2020, në qiejt e 30 shteteve aleate të NATO-s, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Në një mesazh në "Twitter", shoqëruar dhe me video, ambasadorja amerikane, Yuri Kim, shkruan se: "Sot, bombarduesi i Shteteve të Bashkuara B-52 fluturon mbi qiejt e 30 Aleatëve të NATO-s..."



>>> faqe 2

## Ceremonia

### Kapiteni i rangut të parë Ferdinant Kreshpani, emërohet zëvendëskomandant i Forcës Detare

Në mjediset e Komandës së Forcës Detare, u zhvillua ceremonia e emërimit të zëvendëskomandantit të Forcës Detare, kapiten i rangut të parë Ferdinant Kreshpani. Gjatë ceremonisë së prezantimit të zëvendëskomandantit, ishin pjesë Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm Kolonel Ilir Pujo dhe Kolonel Leonard Çoku drejtori i personelit në ShPFA... >>> faqe 2

### KAZERMA "BORO MENKOV" NË KUMANOVË

## Maqedonia e Veriut merr Komandën e Brigadës së Evropës Jug-Lindore 2020-2026

>>> faqe 11

### BAZAT USHTARAKE "GRAFENWOEHR" DHE "HOHENFELS" NË GJERMANI

## Forcat Speciale në stërvitjen "Saber Junction 20"

faqe 5

### DIPLOMIMI NË TURQI

## 9 kadetë kthehen të shërbejnë në Forcat e Armatosura Shqiptare

faqe 5





YURI KIM PUBLIKON VIDEON

# Bombarduesi amerikan B-52 fluturoi mbi qiellin shqiptar

*Stërvitje si kjo ndihmon për të siguruar dhe përmbushur misionin tonë kryesor: të parandalojmë agresionin, të parandalojmë konfliktin dhe të ruajmë paqen*

**B**ombarduesi amerikan B-52 ka fluturuar ditën e premte, më 28 gusht 2020, në qiejt e 30 shteteve aleate të NATO-s, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Në një mesazh në "Twitter", shoqëruar dhe me video, ambasadorja amerikane, Yuri Kim, shkruan se: "Sot, bombarduesi i Shteteve të Bashkuara B-52 fluturon mbi qiejt e 30 Aleatëve të NATO-s, përfshirë edhe Shqipërinë. Nëse nuk keni parë kurrë një B-52, atëherë kjo është një pamje për t'u parë!".

Fluturimi i bombarduesve amerikanë B-52 mbi qiellin shqiptar ishte pjesë e operacionit "Allied Sky" ku gjashtë bombardues amerikanë B-52 kanë fluturuar mbi qiellin e 30 vendeve të NATO-s. Ata kanë fluturuar mbi vendet e rajonit Ballkanik si mbi Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Kroacinë, Slloveninë, Bullgarinë, mbi hapsirën e vendeve perëndimore si Itali, Francë, Britani e Madhe, Gjermani, apo Poloni, Letoni, Estoni e Lituani, etj. e deri mbi qiellin kanadez. Në këtë demonstrim spektakolar u angazhuan katër sulmuesit strategjikë amerikanë të cilët fluturuan mbi Evropë dhe dy mbi Amerikën e Veriut.

Në një ditë të vetme janë realizuar këto fluturime për të demonstruar aleancën dhe garantimin e sigurisë midis vendet antare të NATO-s. Gjashtë avionët bombardues amerikanë janë shoqëruar nga rreth 80 avionë luftarakë nga të gjithë vendet e Aleancës të cilët kanë avionë luftarakë bombardues në arsenalin e tyre të Forcave Ajrore. Kanë qënë avionë nga 20 vende antare të NATO-s të cilët kanë fluturuar përkrah 6 bombarduesve amerikanë: Belgjika, Bullgaria, Kanada, Kroacia, Republika Czecheke, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia,



Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha: "Ngjarja e sotme e trajnimit demonstron përkushtimin e fuqishëm të Shteteve të Bashkuara për NATO-n dhe solidaritetin e Aleatëve në veprim. Ndërsa bombarduesit amerikanë kalojnë mbi të gjithë 30 vendet Aleatë të NATO-s në një ditë të vetme, ata shoqërohen nga avionë luftarakë nga e gjithë Aleanca, duke rritur aftësinë tonë për t'iu përgjigjur së bashku çdo sfide. Stërvitje si kjo ndihmon për të siguruar dhe përmbushur misionin tonë kryesor: të parandalojmë agresionin, të parandalojmë konfliktin dhe të ruajmë paqen."



## Kapiteni i rangut të parë Ferdinand Kreshpani, emërohet zëvendëskomandant i Forcës Detare

**N**ë mjediset e Komandës së Forcës Detare, u zhvillua ceremonia e emërimit të zëvendëskomandantit të Forcës Detare, kapiteni i rangut të parë Ferdinand Kreshpani. Gjatë ceremonisë së prezantimit të zëvendëskomandantit, ishin pjesë Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm Kolonel Ilir Pujo dhe Kolonel Leonard Çoku drejtori i personelit në ShPFA. Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm vlerësoi karrierën dhe aftësitë profesionale të zëvendëskomandantit, e cila do ti shërbejë Forcës Detare në realizimin e misionit të saj. Në fjalën e tij ai shprehu besim se Forca Detare nëndrejtimin e

kapiten të rangut të parë Kreshpani do të vazhdojë të shquhet si një nga strukturat më dalluese të FARSH, gjithashtu i uroi suksese në detyrën e re si drejtues i Forcës Detare. Kapiteni i rangut të parë Kreshpani falenderoi Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA për besimin që kanë treguar nëpërmjet emërimit të tij në këtë detyrë të rëndësishme dhe me përgjegjësi. Ai siguroi Drejtorin e SHP se Forca Detare si dhe efektivat e saj do të vazhdojnë të përmbushin me përgjegjësi të gjitha detyrat dhe misionin e ngarkuar Forcës Detare dhe Rojes Bregdetare.



STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**

**Gazetarë:**  
Saimir **ALIJA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni "Skënderbej"





## Akademia e Forcave të Armatosura

# Përfundon raundi i I-rë i aplikimit, dalin fituesit, më 19-21 shtator raundi i II-të

*Në Akademinë e Forcave të Armatosura, për programin 3 vjeçar të studimeve në fushën e 'Shkencës Ushtarake', pas tre raundeve, do të ulen në auditorë 60 studentë ushtarakë, brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura*

**K**a përfunduar raundi i parë i aplikimit dhe regjistrimit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) në programin e studimeve në fushën e Shkencës Ushtarake.

Raundi i dytë i aplikimeve nis nga data 19 deri më 21 shtator për të gjithë ata që do të jenë brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka bërë me dije përmes një postimi në rrjetet sociale se, në këtë periudhë, të gjithë maturantët që kanë mbaruar këtë vit arsimin e mesëm mund të aplikojnë në portalin ualbania.al.

Gjithashtu aplikimi vijon të jetë i hapur edhe për maturantët e viteve të shkuara. Më 21 shtator përfundon afati edhe për këtë kategori aplikantësh, të cilët duhet të plotësojnë formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar, duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre.

AFA ofron një pagesë mujore për çdo student për të gjithë periudhën e studimit si dhe akomodim dhe ushqim falas për tre vitet e studimit. Çfarë është më e rëndësishmja, studentët nuk paguajnë asnjë tarifë për studimet dhe në përfundim të tyre punësohen përmes mundësive që japin FA.

675 maturantë aplikuan vetëm për raundin e parë për të ndjekur studimet Bachelor pranë AFA. Në përfundim të raundit të tretë pritet të kemi 60 studentët e parë të shkollës sonë ushtarake, shtyllës kryesore të formimit të Forcave të Armatosura.

Më poshtë po botojmë listën e aplikantëve të parë fitues, listë e cila është publikuar me 26 gusht 2020 edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe gjendet në linkun: lista e aplikantëve fitues (raundi i I rë), në programin e studimeve në fushën e 'Shkencës Ushtarake', në AFA.

### Akademia e Forcave të Armatosura

**Aplikantët fitues në programin e studimeve në fushën e "Shkencës Ushtarake" në Fakultetin e Sigurisë dhe Mbrojtjes (Raundi i I rë, 13-18 Gusht 2020)**

IAL	FAKULTETI	PROGRAMI I STUDIMIT	ID MATRANTIT
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	200504700076
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	200707800006
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	200707800023
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	201706500003
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	203625000387
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	205421800007
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	200708000013
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	202629600067
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	202134200020
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	201936100115
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	201418500036
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	205109400036
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	201936000220
Akademia e Forcave Armatosura	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Studime në Shkenca Ushtarake	201939300073

### Zjarri në Mallakastër dhe Roskovec

### Helikopteri "Cougar" i Forcës Ajrore angazhohet në shuarjen e zjarrit

Helikopteri Cougar i Forcës Ajrore nisi ditën e shtunë, më 29 gusht 2020, operacionin për shuarjen e zjarrit në zonën ndërmjet Patosit, Mallakastër dhe Roskovecit.

Pylli midis këtyre tre zonave prej disa ditësh ishte nën pushtetin e flakëve. Pavarësisht ndërhyrjeve nga zjarrfikësit zjarri nuk është shuar për shkak të terrenit tepër të thyer. Forcat zjarrfikëse të Patosit dhe Fierit kanë qenë afër zonës, ku po digjeshin sipërfaqe të mëdha me pyje, në përpjekje për të shuar flakët. Zjarri vijoi të përparojë edhe në drejtim të zonës së Lofkëndit në Mallakastër dhe në pyllin me pisha te Vloshit. Janë djegur disa hektarë me bimë të ndryshme dhe pisha. Helikopteri i Forcës Ajrore i pajisur me botin e ujit, ka arritur të izolojë flakët.



ZV/MINISTRI PETRO KOÇI NË KUMANOVË (KAZERMA "BORO MENKOV") MAQEDONIA E VERIUT

# Koçi: Brigada (SEEBRIG) promovon bashkëpunim dhe stabilitet rajonal

*Zhvillohet ceremonia e aktivizimit të Komandës së SEEBRIG/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (MPFSEE), ceremonia e ndërrimit të komandantëve të SEEBRIG si dhe e festimit të 21-Vjetorit të Komandës së SEEBRIG*

Zoti Petri Koçi, zv/ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e Kryetarit aktual të SEDM-it, mori pjesë në Kumanovë (kazerma "Boro Menkov") të Maqedonisë së Veriut, në një ceremoni solemne, organizuar më 26 gusht 2020, me rastin e vendosjes në këtë vend (me rotacion) të Komandës së Brigadës së Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) për vitet 2020-2026, ndërrimin e komandantëve të SEEBRIG dhe festimit të 21-Vjetorit të Komandës së SEEBRIG.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm krerët më të lartë politikë dhe ushtarakë të Maqedonisë së Veriut si: Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Stevo Pendarovski, kryeministri z. Oliver Spavoski, ministri i Mbrojtjes znj. Radmila Shekerinska, shefi i SHPFA të Maqedonisë së Veriut, gjeneraljtënant Vasko Gjurchinovski, zëvendësministra të Mbrojtjes dhe zëvendëshefa të SHPFA nga vendet e Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (MPFSEE), ambasadorë dhe atashe të Mbrojtjes nga vendet anëtare të PMSC, autoritete lokale dhe personeli i Komandës së SEEBRIG së bashku me familjet e tyre morën pjesë në këtë ceremoni. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu.

Fillimisht të pranishmit morën pjesë në përrurimin e ndërtesës së rinovuar dhe të pajisur e cila do të jetë selia e Shtabit të Përgjithshëm të Brigadës Jug-Lindore (SEEBRIG) deri në vitin 2026. Pas dorëzimit të flamurit nga komandanti i deritanishëm rumun, gjeneral brigade Tudorica Petrache dhe marrjen e detyrës nga Komandanti i Brigadës, Gjeneral brigade Aristedeis Iliopoulos, zv/ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Petro Koçi, ka theksuar rëndësinë e kësaj nisme për rajonin ballkanik dhe më gjerë.

Z. Petro Koçi, si Kryetari i SEDM-it, shprehu vlerësimet dhe falënderimet për autoritetet ushtarake dhe civile të Maqedonisë së Veriut për mbështetjen dhe për kushtet me infrastrukturën e krijuar për Komandën e re të SEEBRIG në Kumanovë, e cila do të jetë "shtëpia e SEEBRIG" për gjashtë vitet e ardhshme. Ai nënvizoi faktin se Forca Shumëkombëshe Paqeruajtëse e Europës Juglindore (SEEBRIG) është një histori suksesi, pasi ka kontribuar shumë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal, në besimin reciprok dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis vendeve të Europës Juglindore. Gjatë ceremonisë, komandanti i SEEBRIG u vlerësua nga kryetari i SEDM-CC/PMSC, z. Petro Koçi, me medaljen "SEEBRIG Accomplishment Medal" për shërbimin dhe realizimin me sukses të detyrave të ngarkuara.

Kurse Komandanti i sapoemëruar i Brigadës, Gjeneral brigade Aristedeis Iliopoulos, tha se "SEEBRIG u krijua 21 vjet më parë për të kontribuar në stabilitetin dhe sigurinë rajonale, si dhe



për të promovuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis shteteve anëtare".

Kurse ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Radmila Sekerinska u shpreh se "Stacionimi i Komandës SEEBRIG në Maqedoninë e Veriut dhe anëtarësimi i plotë në NATO janë

dy gjëra me të cilat mund të jemi të kënaqur, në një vit që do të mbahet mend edhe pas krizës globale të pandemisë së koronavirusit. Kjo na sjell një përgjegjësi të madhe, por gjithashtu tregon se mund të rrisim ndikimin tonë dhe të bëhemi një faktor i fortë për

stabilitetin dhe bashkëpunimin rajonal". "Do ta bëjmë këtë përmes pranisë së selisë së SEEBRIG-ut në vendin tonë, por edhe duke rritur pjesëmarrjen tonë në operacionet e NATO-s në rajon dhe se se është jashtëzakonisht e rëndësishme që vendi të vazhdojë të investojë

në stabilitetin rajonal", deklaroi ministrja e Mbrojtjes, Shekerinska.

Në Brigadën e Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) marrin pjesë Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Maqedonia Veriore, Rumania dhe Turqia.

## SEDMI dhe disa momente kryesore në historikun e SEEBRIG

*Procesi i Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Jug-Lindore (SEDM) dhe i Brigadës së Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) startoi me takimin e ministrave të Mbrojtjes të mbajtur në Tiranë në Mars 1996*

Procesi i Ministrave të Mbrojtjes të Evropës Jug-Lindore (SEDM), filloi me një takim të Ministrave të Mbrojtjes të mbajtur në Tiranë në Mars 1996 i cili kishte tre objektiva kryesore: promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, forcimin e aftësive rajonale të mbrojtjes, si dhe bashkëpunimin përmes përpjekjeve kolektive dhe së fundmi, lidhje që lehtësojnë integrimin në institucionet euro-atlantike. Objektivi kryesor i procesit SEDM është forcimi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit politik-ushtarak në rajon në mënyrë që të rrisë stabilitetin dhe sigurinë në Europën Juglindore.

### Disa momente kryesore në historikun e SEEBRIG

Më 31 gusht 1999, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar u aktivizua SEEBRIG në Plovdiv, Bullgari. Maj 2001 u deklarua gatishmëria operationale e brigadës në operacionet e drejtuara nga OKB, OSBE dhe operacionet paqeruajtëse të drejtuara nga NATO. Prill 2003, PMSC deklaroi se SEEBRIG është gati të marrë pjesë në operacionet paqeruajtëse (PSO) të drejtuara nga NATO e BE. 2003-2007 Komanda e SEEBRIG u dislokua në Konstanca, Rumani. Prill dhe tetor 2004, ekipi i vlerësimit deklaroi Kapacitetet Operationale Fillestare (IOC) dhe Kapacitetet e Plota Operationale (FOC). 2006, SEEBRIG mori pjesë në operacionet në mbështetje të paqes në Afganistan. 2007-2011, Komanda e SEEBRIG u dislokua në Stamboll, Turqi. 2011-2020, Komanda e SEEBRIG u dislokua në Larisa, Greqi. 2020-2026, Komanda e SEEBRIG dislokohet në Kumanovë, Maqedonia e Veriut.



### Objektivat e SEDM

Promovimin e mirëkuptimit, besimit dhe bashkëpunimit reciprok midis vendeve anëtare, kontributi e SEDM-it dhe Brigadës së Evropës Jug-Lindore (SEEBRIG) në sigurinë dhe stabilitetin rajonal dhe botëror, rritje e ndërveprimit dhe aftësisë së SEEBRIG dhe aftësinë për t'u vendosur në misionet mbështetëse të paqes, lehtësimin e punës të SEEBRIG në operacionet e mbështetjes së paqes, promovimin e proceseve integruese Euro-Atlantike të kombeve anëtare të SEDM.

### Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Që nga nënshkrimi i Marrëveshjes në 26 Shtator 1998, SEDM, me vendet e saj anëtare, kanë arritur një përparim të konsiderueshëm. Deri më tani Ministrinë e Mbrojtjes i Evropës Juglindore (SEDM) kanë luajtur rol në forcimin e paqes dhe stabilitetit

në rajonin e Evropës Juglindore dhe kanë kontribuar në përpjekjet e paqes edhe më tej. Gjatë këtyre viteve viteve, forumi SEDM ka qenë efektiv, me dialog që synon ndërtimin e një rajoni më të sigurt dhe më të prosperuar përmes bashkëpunimit të ngushtë rajonal dhe ndarjes së qëllimeve të përbashkëta midis vendeve anëtare dhe kombeve vëzhguese. SEDM ka rritur imazhin e vet në aspektin ndërkombëtar, si një model i shkëlqyeshëm i bashkëpunimit të ndërsjellë midis shteteve që janë të angazhuara për të forcuar paqen dhe stabilitetin rajonal dhe ndërkombëtar. Mbi bazën e këtyre vlerave është forcuar bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, si OKB, NATO, BE dhe OSBE. Kurse instrumenti ushtarak, SEEBRIG, mundëson të punohet më ngushtë së bashku, për të përmirësuar aftësitë e përbashkëta mbrojtëse, për të ndihmuar në bashkimin me organizata më të mëdha si NATO dhe BE, i cili forcon lidhjet Euro-Atlantike.





Bazat ushtarake "Grafenwoehr" dhe "Hohenfels" në Gjermani

# Forcat Speciale në stërvitjen "Saber Junction 20"

Në stërvitjen "Saber Junction 20" nga data 3 deri 27 gusht, morën pjesë 4000 trupa nga SHBA, Shqipëria, Gjeorgjia, Letonia, Lituania, Moldavia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Ukraina

Më shumë se 4,000 pjesëmarrës nga SH.B.A. dhe vendet aleate dhe partnere morën pjesë në stërvitjen "Saber Junction 20", e cila u zhvillua në zonat e stërvitjes "Grafenwoehr" dhe "Hohenfels", të ushtrisë amerikane në Gjermani, në datat 3 deri 27 gusht 2020. U mbledhën së bashku gjashtë aleatë të NATO-s dhe tre partnerë në Gjermani për të provuar forcën e reagimit të ushtrisë amerikane në Evropë.

Konkretisht në këtë stërvitje morën pjesë forca ushtarake nga Shtetet e Bashkuara, Shqipëria, Gjeorgjia, Letonia, Lituania, Moldavia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Ukraina.

Lidhur me praninë e Forcave Speciale Shqiptare, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, shkruan në facebook se "Forcat Speciale shqiptare treguan aftësitë e tyre më të mira krahas 4000 kolegëve aleatë e partnerë nga Shtetet e Bashkuara, Gjeorgjia, Letonia, Lituania, Moldavia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Ukraina në stërvitjen "Saber Junction 20", në bazat ushtarake "Grafenwoehr" dhe "Hohenfels" në Gjermani".

"Saber Junction 20" është një stërvitje vjetore e cila zhvillohet nga Komanda e 7-të për të vlerësuar gatishmërinë e Brigadës 173 të Ajrit



të Ushtrisë Amerikane në Europë, në ekzekutimin e operacioneve tokësore të unifikuar në një mjedis të përbashkët, të kombinuar dhe për të promovuar ndërveprimin midis aleatëve ushtarakë pjesëmarrës dhe vendeve partnere.

"Stërvitja së bashku me aleatët dhe

partnerët tanë është një mision themelor i brigadës sonë. Sa më familjar të jemi me integrimin në sisteme të ndryshme, aq më të përgatitur do të jemi të fitojmë luftime tokësore kundër armikut për ruajtjen e sigurisë." tha koloneli amerikan Kenneth Burgess, komandant

i Brigadës Ajrore 173. "Formati i ri i "Saber Junction 20" lejoi parashutistët tanë të punojnë gjatë gjithë procesit, të provojnë atë plan dhe më pas ta ekzekutojnë atë," tha Burgess. "Ne patëm mundësinë të stërviteshim në MV-22 Osprey të Marins Corps të SHBA, një platformë e re për ne që siguron transport ajror në distanca të gjata për infiltrimin tonë të sulmit ajror në zonën e trajnimit," tha Burgess.

"Pesë etapat në stërvitjen "Saber Junction 20", krijuan një bashkëpunim midis forcave pjesëmarrëse dhe ritrajnimit. Kjo lehtësoi inovacionin dhe kreativitetin nga ana e të gjithëve forcave të përfshira," tha komandanti Sgt. Majori Wendell Franklin, komandant i Grupit të Operacioneve JMRC.

"Duke pasur një forcë të gatshme, kjo na lejon neve dhe partnerëve tanë

të jemi të sigurt se Shtetet e Bashkuara janë këtu për të qëndruar dhe se ne jemi të përkushtuar ndaj aleatëve dhe partnerëve", tha Kapiteni Ryan Lee, Komandant i Batalioni i 2-të, Regjimenti 503, Skuadra Luftarake e Brigadës Ajrore 173. "Rregullat dhe përgjegjësitë e Brigadës 173-të të stacionuar në Evropë na lejojnë t'u përgjigjemi shpejt operacioneve të paparashikuara. Ne kemi aftësinë për të masovuar dhe ndërtuar me shpejtësi fuqinë luftarake në të gjithë Mesdheun, si dhe disa zona të tjera me interes për kombin", tha kapiteni Ryan Lee.

Stërvitja ilustroi aftësinë për të ndërtuar dhe mundësuar gatishmërinë në kohë reale pasi kjo bashkoi njësi të shumta ushtarake amerikane dhe forca shumëkombëshe nën drejtimin e Qendrës së Përbashkët të Gatishmërisë Shumëkombëshe në Zonën e Trajnimit "Hohenfels".

Për të mbështetur këtë stërvitje, automjetet ushtarake kanë përdorur gjithashtu rrugët publike për të konvojuar nga bazat ushtarake "Grafenwoehr" në "Hohenfels" në seri, në datat 5-12 gusht, si gjatë ditës ashtu edhe në mbrëmje. Për shkak të madhësisë dhe peshës së tyre, këto automjete ushtarake lëvizin ngadalë dhe kanë shikueshmëri të kufizuar. Drejtuesit e mjeteve këshillohen të kenë kujdes kur ngasin makinat pranë autokolonave ushtarake. Ekipe të vëzhguesve, stërviten dhe pjesëmarrësit e stërvitjes gjatë fazave të planifikimit, përgatitjes dhe ekzekutimit të operacioneve të simuluar luftarake. Brigada Ajrore 173-të gjithashtu ka rritur ndërveprimin me njësitë e tjera ushtarake amerikane gjatë stërvitjes.

U diplomuan në Turqi në Akademitë e Forcës Tokësore, Ajrore dhe Detare

## 9 kadetë kthehen të shërbejnë në Forcat e Armatosura Shqiptare

Midis 630 kolegëve të tyre nga 17 vende të botës, kadetët shqiptarë përfunduan studimet "bachelor" dhe ato të përgatitjes ushtarake në Akademinë e Forcës Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe do të kthehen të shërbejnë në Forcat e Armatosura të RSH

Kadetët shqiptarë përfunduan studimet "bachelor" dhe ato të përgatitjes ushtarake në Akademinë e Forcës Tokësore, Ajrore dhe Detare dhe do të kthehen të shërbejnë në Forcat e Armatosura të RSH.

Në ceremoninë e dorëzimit të diplomave të studentëve shqiptarë në Akademinë e Forcës Tokësore, në Ankara ishin të pranishëm: presidenti i Republikës së Turqisë, z. Recep

Tayip Erdogan, kryetari i Parlamentit të Turqisë, z. Mustafa Sentop, ministri i Mbrojtjes, z. Hulusi Akar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA turke, gjeneral Yasar Guler, rektori i Universitetit të Mbrojtjes Kombëtare, prof. dr. Erhan Afyoncu, zëvendësatashu ushtarak i Shqipërisë, në Turqi, nënkolonel Majlinda Sallaku, etj.

Kadetëve shqiptarë, të cilët mbaruan akademinë me rezultatet më

të larta, përkatësisht Mario Meni i Forcës Tokësore, Rodilen Allkanjari i Forcës Detare dhe Juxhin Marku i Forcës Ajrore, iu dorëzua diploma nga zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Muhsin Dere, i cili i ka falënderuar ata për rezultatet e larta të arritura, në Akademinë e Forcës Tokësore. Forcat e Armatosura të RSH, vijojnë të shtohen me të rinj të arsimuar në akademitë më prestigjioze të botës.



### NATO PUBLIKON FOTON

#### Rreshter Vladimir Bajramaj në Letoni duke demontuar një minë

NATO ka publikuar në faqen e saj foton e rreshter Vladimir Bajramaj, pjesë e kontingjentit shqiptarë në Letoni duke demontuar një minë kundërtank. Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka duke përcjellë foton shprehet se: "Rreshter Vladimir Bajramaj, pjesë e kontingjentit shqiptar në grup-batalionin e NATO-s në Letoni, duke demontuar një minë kundërtank gjatë stërvitjes BEAVER PRIME në Camp Ādaži". Rreshter Vladimir Bajramaj, është pjesë e Kontingjentit VII, EOD, i cili

ka mbërritur në Letoni në fillim të muajt korrik 2020, si pjesë e grup -batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze të dislokuara në Letoni. Kontingjenti VII-te, EOD përbëhet nga 21 efektivë.







PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

## Detyrat strategjike

Komiteti Mbrojtja Kombëtare, i krijuar në mars të vitit 1920, i mbledhur në fshehtësi, u muar me zgjidhjen e detyrave themelore strategjike. Ndër detyrat strategjike me përparësi ishin vlerësuar organizimi ushtarak, hartimi i planit të përgatitjes dhe zhvillimit të Luftës për çlirimin e Vlorës dhe bashkimin e saj me pjesën tjetër të Shqipërisë, si dhe zgjidhja e çështjes së drejtimit të forcave dhe të veprimeve luftarake. Në këtë plan, përveç masave për ruajtjen gjatë afrimit, grumbullimit dhe përgatitjes së forcave vullnetare luftarake për në vendet e grumbullimit dhe të përgatitjes, në mënyrë skrupuloze dhe me fanatizëm, tërheqin vëmendjen disa veçori të pazakonta në përfaqje me ato mëparë. Ruajtja e fshehtësisë kishte për synim, dhe në të vërtetë ia doli që të vinte, si të thuash “në gjumë”, kultivoi mosbesimin, indiferencën dhe avashllëkun tek Komanda e Forcave Pushtuese në Vlorë, e cila nuk besonte në mundësitë luftarake dhe në guximin e shqiptarëve. Kështu, kryengritësit i zunë gati-gati në befasi të plotë pushtuesit, me shpërthimin e sulmit, veçanërisht në Fazën e Parë të Luftës. Kjo masë bëri që njëherësi, të ruhej fshehtësia strategjike, si dhe të sigurohej sukcesi prej luftëtarëve vendas. Në organizimin e forcave luftarake të grumbulluara për kryengritje, u mbajtën parasysh disa faktorë, që ishin të rëndësishëm dhe përcaktues, si koha, rrethanat, trashëgimia organizative dhe luftarake, resurset njerëzore të krahinës, sasia dhe cilësia e armatimeve dhe municioneve, mjeteve luftarake etj. Në këto rrethana, u gjetën dhe u përzgjedhën forma të thjeshta dhe të shpejta organizative tradicionale luftarake, që vinin në përputhje me armatimet, mjetet, pajisjet e tjera dhe mundësonin kompaktësinë, komandimin gjatë lëvizjeve dhe manovrave të shpejta, shfrytëzimin e terrenit, si dhe përdorimin e taktikës tradicionale partizane, por dhe atë frontale.

Parimi i mobilizimit të forcave kryengritëse mbeti vullnetarizmi, ndërsa si formë organizative u përzgjedhën çetat e fshatrave dhe ato të krahinave. Për rrjedhojë, në një kohë relativisht të shkurtër u organizuan 7 çeta krahinore, secila me disa çeta fshatrash, që përmbidhte krahina përkatëse. Të gjitha çetat së bashku kapnin shifrën 4.000 luftëtarë. Përzgjedhja e çetës si formacioni organizativ dhe luftarak bazë i veprimt në fushën e luftimit nuk u bë sepse nuk ishin mundësitë dhe aftësitë ushtarake për të aplikuar një formë tjetër alternative ushtarake bashkëkohore. Arsyet e vërteta qëndronin në mungesën e kohës së nevojshme për të organizuar dhe kryer këtë proces special, si dhe për stërvitjen dhe kompaktësimin e tyre për të vepruar në fushën e luftës sipas taktikave që përdorin ushtritë e rregullta, profesioniste. Por ishin

# Strategjia e forcave kombëtare në Luftën e Vlorës 1920



edhe faktorë të tjerë, që lidheshin me armatosjen, pajisjen, vedqëndrimet, ushqimin etj. Nga ana tjetër, Qeveria Shqiptare e Tiranës nuk kishte ende një ushtri të rregullt të organizuar, për të mbështetur ushtarakisht kryengritësit vlonjatë.

## Zhvillimi i luftimeve

Në ecurinë e Luftës së Vlorës zhvillimi i luftimeve vërtetoi saktësinë e shumë prej pikave të këtij plani. Ndër detyrat e para strategjike, që zgjidhi Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare ishte çështja e drejtimit të Luftës së Vlorës, në të cilin përfshihej gjithë zinxhiri i drejtimit, nga strategjik deri në nivelin taktik. Organi më i lartë, i sferës politiko-ushtarake, i cili bënte drejtimin strategjik, ishte Komisioni i Mbrojtjes Kombëtare, ose ndryshe Këshilli i Luftës me përbërje prej 12 vetë, me në krye intelektualin e njohur adhetar vlonjat, Osman Haxhiun. Pranë këtij organi u krijua një organizëm tjetër, Komisioni Ushtarak, apo Shtabi Ushtarak, i cili nuk ishte gjë tjetër përveçse një lloj organizmi ushtarak i specializuar, që merrej pikërisht me përgatitjen e planeve të luftës dhe drejtimin e tyre në fushën e luftimeve. Në përbërje të këtij organizmi special me porosinë e Qeverisë së Tiranës ishte futur një grup i vogël oficerë shqiptarë të karrierës, i cili do të jepte ekspertizë për çështjet ushtarake në hartimin e planit, si dhe gjatë zhvillimit të luftimeve. Ky grup, bashkë me Komandantin e Përgjithshëm, ndikuan në përpilimin e një plani luftime sa më objektiv dhe të bazuar në pikëpamje ushtarake, por dhe në plotësimin e realizimi e tij në ecurinë e luftës. Zinxhiri i Drejtimit dhe i Komandimit përmbylej me bllokun e komandantëve të çetave. Në mungesë të mjeteve të drejtimit modern, drejtimi u bazua tek ndërlidhja tradicionale, me korrierë dhe me sinjale. Megjithatë, drejtimi bëhej edhe drejtpërdrejt, duke dërguar pranë reparteve kryengritëse përfaqësuesit e Komitetit të Mbrojtjes.

Më së pari, operacioni i zhvil-

luar në Luftën e Vlorës, rikonfirmoi praninë dhe rëndësinë e një parimi tejet të rëndësishëm, me peshë dhe vlera vendimtare për fatet e veprimeve luftarake si dhe të vet kryengritjes, faktorin moralo-psikologjik dhe rolin e tij përcaktues në luftë. Rëndësia dhe roli i këtij parimi themelor shfaqen dhe bëhen përcaktues pikërisht atëherë kur epërsia në forca njerëzore, në armatime, mjete dhe teknikë luftarake, nuk është në anën e atij që lufton për një çështje dhe ideal të drejtë, në mbrojtje apo në kërkim të lirisë, idenditetit dhe integritetit kombëtar. Dhe megjithatë, edhe në këto rrethana, ja del të fitojë! Vërtetësinë e rëndësisë përcaktuese të këtij parimi i luftës, çlirimi i krahinës dhe ribashkimi i saj me pjesën tjetër të atdheut të pavarur e sovran. Ndërkohë, ekzistenca dhe roli i veçantë e me peshë i këtij parimi, që në këtë rast ishte në anën e forcave vendase, megjithëse në dukje teorik dhe ca patetik, ndikoi ndjeshëm në zbutjen dhe ekuilibrimin e disproporcioneve të theksuara, sidomos në pikëpamje të raportit të forcave dhe mungesave të mëdha në armatimet dhe municionet, si dhe në treguesit e tjerë të natyrës ushtarake në këtë luftë të pabarabartë.

## Raporti klasik i forcave

E parë nga një këndvështrim tjetër, duke gjykuar për nga numri dhe raporti klasik i forcave, armatimeve dhe i mjeteve të tjera luftarake, si dhe i masave paraprake të shumta të përdorura nga të dy palët në këtë luftë, sidomos nga ana e pushtuesve, mund të thuhet pa asnjë mëdyshje se forcat kryengritëse shqiptare i

bënë një sfidë të dytë, në thelb më kryesore, armikut përballë. Në se u besojmë dhe u referohemi statistikave historiko-ushtarake të kohës, kur po përgatitej Lufta e Vlorës, ato tregojnë se pushtuesit italianë, edhe pse Lufta e Parë Botërore kishte kohë që ishte përmbyllur, mbanin ende në Vlorë dhe në zonat përreth, forcat e Korpusit të Trupave të Shqipërisë, nën komandën e gjeneralit Settimo Piacentini, i cili numëronte afro 20.000 ushtarake. Prej tyre 14.000 vetë ishin përqëndruar në trekëndëshin strategjik Vlorë-Sarandë-Tepelenë, që ishin efektiva të Div. 36 K, si dhe disa reparte speciale të Korpusit. Divizioni tjetër i këtij Korpusi, me 6.000 ushtarake ishte vendosur në Durrës. Për të mbrojtur Vlorën ata kishin në përdorim dhe armë të rënda, si mitralozë, topa të kalibrave të ndryshëm, teknikë dhe mjete të shumta luftarake. Në mbështetje të tyre kishin dhe një skuadër tankiste dhe një tjetër ajrore, si dhe artilerinë e anijeve luftarake. Këto forca ishin shpërndarë në mbrojtje në tri vija dhe në disa garnizone të fortifikuara, të fuqishme.

Përballë këtyre forcave dhe masave mbrojtëse te armikut, u vendosën për një përballje luftarake për jetë a vdekje forcat kryengritëse vlonjate, me vetëm 4.000 luftëtarë. Në pikëpamjen numerike formale, në prag të fillimit të fazës së parë, raporti real i forcave paraqitej me shifrat 14.000:6.000 ose 2.3:1 në dobi të pushtuesit. Përsa i përket raporteve në armatime dhe teknikë luftarake epërsia ishte absolute për ta. Por, koha dhe fusha e luftës vërtetoi se përgjigja iu kthye në bumerang gjeneralit! Veprimet luftarake, të shpejta dhe të befasishme të luftëtarëve kryengritës, bënë që të heshtnin topat në Vlorë dhe në garnizonet përreth saj. Në rrjedhën e luftës, raporti i forcave, armatimeve dhe municioneve të vullnetarëve shqiptarë erdhi në rritje për shkak të forcave vullnetare që mbërritën nga krahinat e tjera të vendit si dhe armëve e mjeteve luftarake të kapura armikut. Ndërsa në fazën

e parë të luftës, KMK-ja kishte në gatishmëri dhe përdori vetëm 4.000 mijë luftëtarë, në fazën e dytë ky numër u rrit deri në 6.000 luftëtarë. Megjithëkëtë raporti i forcave asnjëherë nuk shkoi përtej përpjestimit 2:1 për armikun. Kryengritësit u përpoqën dhe shpesh i a dolën mbanë që ta kompensosin këtë diferencë me gjendjen e lartë moralo-psikologjike dhe nivelin e motivimit, me shpirtin sulmues, veprimet e shpejta dhe të fshehta, shfrytëzimin e natës dhe të terrenit të njohur, si dhe manovrës së lartë etj. Kështu, ata ia dolën mbanë të detyronin kundërshtarin të tërhiqej nga Vlora përfundimisht.

## Taktikat e përdorura

E parë në një vështrim që shkon përtej euforisë, frymës së miteve dhe legendave, ajo luftë solli vërtet disa të veçanta në zbatimin e treguesve të artit ushtarak të kohës. Tërheqin vëmendjen sidomos taktikat e përdorura me sukses prej luftëtarëve vlonjatë për shpërthimin dhe kapjen e garnizoneve të fortifikuara, të ngritura prej armikut në vijat e mbrojtjes, si në Kotë, Gjorm, Drashovicë, Matohasanaj, Llogora, Himarë dhe Tepelenë. Kryengritësit, megjithëse me forca dhe sidomos me armatime dhe mjete luftarake shumë më të pakta dhe të vjetëruara, ia dolën që ti kapnin ato dhe efektivat e tyre, duke e vënë nën kërcënim serioz qëndresën e pushtuesve brenda Vlorës dhe në rrethinat e saja. Taktika e përdorur kundër këtyre garnizoneve, me afrimin në mënyrë të fshehtë dhe natën, duke i rrethuar ato veç e veç dhe duke krijuar raporte forcash me epërsi minimale për sulmuesit, si 1.7:1 në Kotë, e cila pas një sulmi të fuqishëm ra në duart e sulmuesve shqiptarë, qe mjaft racionale dhe rezultative. Kështu u morën shumica e këtyre garnizoneve, përveç atij të Tepelenës, i cili u mbajt i bllokuar në një rrethim të plotë dyjavorë, derisa i gjithë efektivi i tij, oficerë dhe ushtarë, u dorëzua pa kushte. Ky lloj luftimi dhe taktikat e përdorura për kapjen e tyre ishin një përvojë e re, e zbatuar me shumë sukses prej forcave kryengritëse vlonjate, por dhe në fondin e artit ushtarak shqiptar, në tërësi.

Lufta e Vlorës është një simbolikë, një shembull i qartë i luftës që mund të bëjë dhe të fitojë një popull, sado i vogël, për të rifituar lirinë, idenditetin dhe integritetin e vendit të tij. Në emër të tyre ai mund të japë pa hezitim si çmim dhe jetën e bijve të vet! Lufta e Vlorës i kishte arritur qëllimet e veta dhe krahina historike tashmë ishte përsëri pjesë e pandashme e Shqipërisë. Ndërkohë, në aspektin luftarake dhe të artit ushtarak, ajo kishte përvijuar dhe afirmuar një përvojë të re, me të veçantat e veta dhe kishte hyrë në fondin e Historisë Ushtarake Shqiptare.



**M**e rastin e 100 vjetorit të Luftës së Vlorës, Presidenti i Republikës Ilir Meta, duke theksuar rëndësinë historike dhe atdhetare të Luftës së Vlorës si dhe shëmbullin e paharruar e frymëzues të saj, sidomos për brezat e rinj, në një ceremoni solemne organizuar në Muzeun Historik Kombëtar, i ka dhënë titullin “Mjeshtër i Madh”, historianit ushtarak Prof. As. Dr. Bernard Zotaj. Presidenti Meta theksoi se:

“Prof. As. Dr. Bernard Zotaj është historian ushtarak, kryetar i Shoqatës së Historianëve Ushtarakë të Republikës së Shqipërisë, i cili i ka kushtuar një pjesë të rëndësishme të studimeve të tij Luftës së Vlorës, luftëtarëve të saj dhe artit ushtarak të aplikuar në të. Gjatë karrierës së tij 40-vjeçare, Prof. As. Dr. Zotaj ka dhënë mësim në shkollat ushtarake dhe ka publikuar në vijimësi hulumtime mbi historinë ushtarake. Për kontributin e tij në fushën e historisë ushtarake nderoj sot Prof. As. Dr. Bernard Zotaj me Titullin e lartë “Mjeshtër i Madh”.

Në nderim të sakrificave të luftëtarëve të Luftës së Vlorës të vitit 1920, dhe në vlerësim të punës së jashtëzakonshme të historianëve e studiuesve tanë për të pasqyruar këtë luftë heroike, Presidenti Meta ka vlerësuar me tituj të lartë nderi edhe disa figura të tjera të historigrafisë si: Prof. Muin Çami, Prof. Dr. Bardhosh Gaçe dhe dhe njëkohësisht tri luftëtarë të shquar të Luftës së Vlorës: Dr. Ali Mihali, Ali Spahiu (Malindi) dhe arbëreshin Xhovani Valenca.

Prof. Muin Çami i përket plejadës së historianëve më në zë të Shqipërisë. Ndër të parët historianë që ka shkruar për Luftën e Vlorës. Studiues dhe hulumtues i njohur si edhe një nga historianët që ka dhënë një ndihmesë të madhe në ngritjen e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë. Prandaj nuk kishte vend më të bukur për ta nderuar atë me Titullin e lartë ‘Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut’.

Një personalitet tjetër është Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, te cilit ju dha titulli ‘Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut’. Prof. Gaçe është studiues dhe profesor në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”. Është një nga autorët që ka lënë gjurmë në përshkrimin e figurave kryesore të Luftës së Vlorës të vitit 1920. Prof. Gaçe është autor i shumë veprave studimore, etnokulturore dhe antologjike. Shumë nga librat e tij të botuar lidhen me baladat, me legendat dhe me historinë e Labërisë së tij.

Ali Spahiu (Malindi) është një nga figurat e shquara intelektuale shqiptare, me një veprimtari të dendur atdhetare në shërbim të Shqipërisë për më shumë se gjysmë shekulli. I lindur në Malind të Skraparit, ai ndoqi studimet në Gjimnazin ‘Zosimea’ të Janinës ku u njoh me miqësua me vëllezërit Frashëri, për të vazhduar studimet e larta në Shkencat Politike-Administrative në Stamboll. Përkushtimi i tij ndaj atdheut e shoqëroi në të gjitha detyrat



## Me rastin e 100 vjetorit të Luftës së Vlorës

# Historianit ushtarak Prof. Ass. Dr. Bernard Zotaj, i jepet titulli “Mjeshtër i Madh”



që mbuloi si Kryetar Bashkie i Vlorës, si sekretar i prefekturës dhe nën/prefekt i Beratit. Ky përkushtim doli akoma më shumë në pah gjatë Luftës së Vlorës, kur iu përgjigj Komitetit ‘Mbrojtja Kombëtare’ për mobilizimin e luftëtarëve në Berat, Skrapar e Lushnje. Edhe pse i moshuar, si komandant i çetës së luftëtarëve të krahinës së tij, mori pjesë në frontin e luftës, ku luftoi me trimëri kundër pushtuesve italianë. Për kontributin e tij të veçantë në Luftën e Vlorës dhe për çështjen shqiptare Presidenti Meta i akordoi ‘Dekoratën e Artë të Shqiponjës’.

Dr. Ali Mihali ishte mjek ushtarak i lindur në Prishtinë, i rritur e edukuar me ndjenja atdhetare që në fëmijëri. Me ardhjen në qytetin e Vlorës në vitin 1911, ai ia kushtoi gjithë jetën e tij çështjes kombëtare, duke u përfshirë në lëvizjen kombëtare në Vlorë si mjek i

kryengritjeve Vlorë-Mallakastër 1912, si mjek pranë qeverisë së Ismail Qemalit në vitet 1912-1914, për të vazhduar me ngritjen e spitalit të Vlorës në vitin 1914, drejtor i të cilit shërbeu për 20 vite rresht. Në vitin 1920, ai u vu në shërbim të Komitetit ‘Mbrojtja Kombëtare’ në spitalin e Kotës, së bashku me Dr. Shezai Çomo, për mjekimin e të plagosurve të luftës së Vlorës. Për kontributin e tij të shquar në Luftën e Vlorës, për humanizmin e trimërinë i’u akordua titulli i lartë ‘Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut’.

Arbëreshi Xhovani Valenca është një figurë e rëndësishme dhe unike në Luftën e Vlorës 1920, sepse kreu një akt të pashembullt e heroik duke braktisur vullnetarisht radhët e ushtrisë pushtuese italiane në Shqipëri, duke u bashkuar me kryengritësve shqiptarë në Luftën e Vlorës dhe duke u dorë-

zuar atyre depot me municione.

Pas dëbimit të ushtrisë italiane nga vendi ynë, ai qëndroi në qytetin e Vlorës, ku solli dhe familjen e tij. Fashistët italianë e konsideruan si tradhëtar dhe organizuan vrasjen e tij në Vlorë në vitin 1927. Giovanni Valenza mbetet një figurë e shquar dhe e pavdekshme në epopenë e Luftës së Vlorës 1920. Për kontributin e tij të çmuar gjatë Luftës së Vlorës iu akordua Titulli i lartë ‘Kalorës i Urdhërit të Flamurit’.

Në fjalën e Tij përshëndetëse Presidenti i Republikës, duke iu drejtuar të rinjve studentë, akademikëve, historianëve dhe të afërmve dhe familjarëve të pranishëm në ceremoninë solemne të zhvilluar në Muzeun Historik Kombëtar, u shpreh: “Jam i lumtur që ndodhemi sot në Muzeun Historik Kombëtar, për të përkujtuar me krenari 100-vjetorin e epopesë së Luftës së Vlorës të vitit 1920. Jemi këtu në Muzeun Historik Kombëtar ku është ekspozuar historia jonë kombëtare, histori e cila pa mundin dhe kontributin e historianëve tanë të nderuar do të ishte e harruar, prandaj vlerësimi dhe mirënjohja në këtë përkujtim të 100-vjetorit të Luftës së Vlorës, është edhe një nder i merituar për punën e bërë prej tyre ndër dekada. Pasqyrimi që i kanë bërë historianët tanë betejave dhe përlëshjeve me armikun, kanë skalitur portretin e Luftës së Vlorës, të atdhetarëve, të kapedenëve të çetave dhe të luftëtarëve të Vlorës, Tepele-nës, Himarës, Gjirokastrës, Beratit, Mallakastrës, Korçës, Devollit dhe gjithë trevave të kombit tonë, deri edhe të diasporës sonë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vende të tjera evropiane.

Ky pasqyrim na jep të plotë këtë epope të fitimtarëve, që nuk lejoi

copëtimin e trojeve shqiptare. Na tregon për një ngjarje historike të rëndësishme të jashtëzakonshme kombëtare, vendimtare për ekzistencën e shtetit tonë, por edhe për mbrojtjen e identitetit tonë kombëtar. Një ngjarje ku shqiptarët u ngritën në këmbë kundër pushtuesit të huaj, vetëm të bazuar në forcat e tyre, pa u ndihmuar ushtarakisht nga askush.

Evropa shkruajn’ e thonë,  
Bëhet dyfek në Vlorë,  
Shqipëtarët luftojnë,  
Me një mbret dyzet milionë...

Jam i lumtur që bashkë me të ftuarit e tjerë në këtë ceremoni, kemi edhe një grup të rinjsh e të rejash, që besoj se, në vizitën e sotme në Muze, kanë mësuar disa gjëra më shumë për historinë e Luftës së Vlorës nga historianët tanë.

Është thelbësore që historinë t’juja mësojmë brezat e rinj, duke mbajtur të gjallë të ardhmen e atdheut. Nuk mund të lejojmë, që e shkuara të lihet në harrësë, apo siç na ka mësuar Ismail Qemali se: ‘Një fëmijë që fle rritet, por një komb që fle vdes’.

Shqipëria duhet të jetë gjithmonë zgjuar në mbrojtje të lirisë, pasi ajo nuk fitohet një herë e përgjithmonë, por duhet mbrojtur në çdo kohë nga të gjithë.

Histori do të thotë “të kërkosh në të kaluarën”, ndaj unë nxis të gjithë historianët tanë të nderuar të vazhdojnë me hulumtimet e tyre, të kërkojnë edhe më shumë në të kaluarën krenare të popullit shqiptar për të mbajtur të gjallë historinë dhe të ardhmen e kombit tonë, duke hedhur më shumë dritë mbi të vërtetat e patjetërsueshme të historisë sonë të lavdishme, që do ndihmojnë brezat e sotëm e të ardhshëm të ndërtojnë një të ardhme më të mirë, më të ndritur dhe me më shumë dashuri për atdheun tonë.



JENS STOLTENBERG-ANGELA MERKEL

# NATO është për Europën dhe Amerikën e Veriut

*Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg zhvilloi një takim në Berlin me 27 gusht me Kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel*

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg zhvilloi një takim në Berlin me 27 gusht me Angela Merkel, Kancelare e Gjermanisë. Z. Stoltenberg falënderoi Kancelaren Angela Merkel për përkushtimin e saj ndaj Aleancës transatlantike dhe udhëheqjen e saj të fortë, përfshirë përpjekjet për të gjetur një mënyrë zgjidhje konstruktive për situatën në Mesdheun Lindor. Ai theksoi se “situata duhet të zgjidhet në një frymë solidariteti Aleat dhe në përputhje me ligjin ndërkombëtar, dialogu dhe depërshkallëzimi janë në interesin e të gjithëve”. Z. Stoltenberg përsëriti se të gjithë Aleatët e NATO-s mbështesin një Bjellorusi sovranë dhe të pavarur. Ai e bëri të qartë se NATO nuk ka tendencë ushtarake në rajon “kështu që çdo përpjekje për ta përdorur atë si një justifikim për të goditur protestuesit paqësorë është absolutisht i pajustificuar”. Ata diskutuan gjithashtu një sërë çështjesh të tjera, përfshirë misionin e NATO-s në Afganistan dhe procesin e reflektimit të NATO-s 2030 për të forcuar Aleancën. “NATO është për Evropën dhe Amerikën e Veriut që punojnë së bashku për t’i mbajtur vendet tona të sigurta. Shtetet e Bashkuara kanë njoftuar rregullime në praninë e tyre ushtarake në Evropë ndërsa mbeten të përkushtuar për sigurinë

evropiane. Është e rëndësishme që Aleatët të vazhdojnë të konsultohen nga afër. Sepse prania e SHBA në Evropë është e rëndësishme si për sigurinë e Evropës, dhe për sigurinë e SHBA”,- tha Stoltenberg. Z. Stoltenberg shoqëruar nga Annetre Kramp-Karrenbauer, ministria gjermane e mbrojtjes, iu drejtua gjithashtu misionëve dhe operacioneve të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm mori pjesë në Berlin në datat 26 dhe 27 gusht, në takimin jozyrtar të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të BE, të organizuar nga Presidenca Gjermane e Bashkimit Evropian. Ai azhurnoi ministrat për misionet e NATO-s në Afganistan dhe Irak, ku Aleanca po ndihmon në ndërtimin e kapacitetit të forcave të sigurisë dhe stabilitetin e projektit. Z. Stoltenberg gjithashtu u takua me Përfaqësuesin e Lartë të BE-së-Zëvendës Presidentin e Komisionit Evropian Josep Borrell. Ata diskutuan rëndësinë e bashkëpunimit NATO-BE për t’u marrë me sfidat e përbash-



këta. Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me ministrin e Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, Nikolaos Panagiotopoulos, dhe Ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolaos Dendias.

## Forca Ajrore gjermane dhe “Dita Shumëkombëshe” e ajrit

*Morën pjesë avionë luftarakë nga Gjermania, Hungaria dhe Izraeli si partner i NATO-s*

Forca Ajrore Gjermane zhvilloi më fund të muajit gusht “Ditën Shumëkombëshe” të Ajrit ose “MAGDAY” për vitin 2020. Avionë luftarakë dhe avionë cisternë nga Gjermania, Hungaria dhe Partneri i NATO-s Izrael kanë praktikuar stërvitjen ajrore në një mjedis shumëkombësh. Katër stërvitje “MAGDAY” janë planifikuar zakonisht një vit dhe gjermanët i presin ato si Korniza Kombëtare për projektin ajror. Sidoqoftë, për shkak të ndikimit të pandemisë koronavirus, numri i stërvitjeve është reduktuar në dy për vitin 2020. Stërvitja e parë “MAGDAY” u zhvillua në qershor me pjesëmarrës nga Republika Çeke, Franca, Gjermania, Polonia dhe Sllovakia. Fokusi i “MAGDAY”-s që përfundoi në 27 gusht kishte si objekt vendosjen e epërsisë ajrore në një zonë duke angazhuar sistemet e mbrojtjes ajrore të bazuar në tokën e një kundërshtari fiktiv. Një tjetër theks i veçantë i ngjarjes ishte fakti që për herë të parë, Forca Ajrore Izraelite dërgoi aeroplanë luftarakë F-16 dhe një “Boeing 707” për të marrë pjesë në këtë stërvitje. Izraeli është një vend partner i NATO-s nën



programin e Dialogut Mesdhetar.

Prania e avionëve hungares “Gripens JAS-39” ishte për herë të katërt në “MAGDAY”-s. Pesë avionët “Gripens JAS-39” u vendosën në Jagel në Gjermaninë veriore dhe realizuan misione fluturimi.

Gjatë një faze të stërvitjes, “Gripens” hungares u ngrit në një zonë të përkohshme stërvitore të veçuar mbi Detin e Veriut, ku u takua gjatë stërvitjes ajrore me avionin izraelit

F-16 dhe avionet gjermane. Grupet shumëkombëshe ajrore janë forca të kombinuara të detyrave ajrore; ato përbëjnë bazën për operacionet e NATO-s dhe ndihmojnë në përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak brenda Aleancës dhe me Partnerët. Izraeli është një shembull i mirë se si anëtarët jo të NATO-s, mund t’i aplikojnë taktika, teknika dhe procedura të NATO-s – me një përvojë e mirëpritur.

### STANDARDE NË PROJEKTET E ALEANCËS

#### Projekti i municioneve i NATO-s dorëzohet një vit para afatit

Më 1 shtator 2020, Agjencia e Prokurimit dhe Mbështetjes së NATO-s (NSPA) mori të parën nga tre dërgesat e Municioneve të Drejtuara me Precision (PGM) për vitin 2020. Ato u morën përmes një prej Projekteve shumëkombëshe të NATO-s me Dukshmëri të Lartë që përfshin 13 Aleatë dhe një partner të NATO-s (1) PGM-të, të prodhuara në Shtetet e Bashkuara. Dërgesat po arrijnë midis tre deri në dymbëdhjetë muaj para afatit. Vlera totale e kësaj blerjeje është mbi 44 milion dollarë amerikanë. I nisur në 2014 në Samitin e Uellsit, projekti i NATO-s u ofron pjesëmarrësve një kornizë për të marrë PGM ajër tokë, me kosto efektive dhe fleksibël. Duke punuar përmes kësaj iniciative, pjesëmarrësit tashmë kanë arritur të ulin kostot e tyre të blerjes me 15-20%. Një përfitim tjetër i shtuar është se pjesëmarrësit janë në gjendje të tërheqin rezervat PMG të njëri-tjetrit shumë më lehtë, për shembull gjatë operacioneve ajrore ose në një krizë të mundshme. Ky fleksibilitet do të thotë që kohët e përpunimit mund të reduktohen nga muaj në javë ose ditë. Duke njohur këto përfitime, pjesëmarrësit kanë rritur porosinë e tyre përmes projektit të NATO-s. Porosia më e fundit, e vlerësuar në 44 milion dollarë amerikanë, është më shumë se dyfishi i rendit të parë shumëkombësh. Numri i municioneve dhe përbërësve të ndryshëm të



prokuruar përmes projektit është zgjeruar gjithashtu, nga katër në 15. Në 2021, projekti pritet të ofrojë përfitime të mëtejshme duke hapur dyert e një strukture të parë shumëkombëshe të magazinës së municioneve për pjesëmarrësit. “Kjo përpjekje ka vendosur standardin në të gjithë portofolin tonë të Projekteve shumëkombëshe me Dukshmëri të Lartë. Duke shtuar me sukses një pasuri përfitimesh dhe veçorish të reja, ajo ka ndërthurur një rast bindës dhe tërheqës për Aleatët dhe kombet partnere për të përfituar plotësisht nga të gjitha ato që mund të ofrojnë”, tha Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Investimet e Mbrojtjes, Camille Grand. NATO gjithashtu ka projekte të ngjashme për blerjen e municioneve tokësore dhe detare që ofrojnë përfitime të krahasueshme. Kjo është pjesë e punës së NATO-s për të rritur investimet e përbashkëta në aftësitë kritike që i duhen Aleancës. Pjesëmarrësit janë Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Finlanda, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar.



“Allied Sky”-Gjashtë bombardues amerikanë mbi vendet e NATO-s

# Stoltenberg: SHBA demonstroi solidaritetin me vendet e NATO-s

*Avionët nga 20 Aleatët e NATO-s kanë fluturuar përkrah 6 bombarduesve amerikanë: Belgjika, Bullgaria, Kanada, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.*

**G**jashtë avionë bombardues B-52 të Forcave Ajrore Amerikane, kanë fluturuar të premten, më 28 gusht 2020 mbi hapësirën europiane të të gjitha vendeve antare të NATO-s, duke u stërvitur së bashku me Forcat Ajrore të vendeve aleate. Ndërsa katër sulmuesit strategjikë amerikanë fluturojnë mbi Evropë dhe dy mbi Amerikën e Veriut për këtë ngjarje të planifikuar për një kohë të gjatë, të quajtur “Allied Sky”, ata do të shoqërohen nga rreth 80 avionë luftarakë nga e gjithë Aleanca, duke ofruar një mundësi për të rritur aftësinë e aleatëve për të trainuar dhe vepruar së bashku me njëri-tjetrin.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha: “Ngjarja e sotme e trajnimit demonstroi përkushtimin e fuqishëm të Shteteve të Bashkuara për NATO-n dhe solidaritetin e aleatëve në veprim. Ndërsa bombarduesit amerikanë tejkalojnë të gjithë 30 Aleatët e NATO-s në një ditë të vetme, ata po shoqërohen nga avionë luftarakë nga e gjithë Aleanca, duke rritur aftësinë tonë për t’iu përgjigjur së bashku çdo sfidë. Stërvitje si kjo ndihmon për të siguruar dhe përmbushur misionin tonë kryesor: të parandalojmë agresionin, të parandalojmë konfliktin dhe të ruajmë paqen.”

Avionët nga 20 Aleatët e



NATO-s kanë fluturuar përkrah 6 bombarduesve amerikanë: Belgjika, Bullgaria, Kanada, Kroacia, Republika Çecheke, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia,

Spanja, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Bazuar në krahun e 5-të të bazën e forcave ajrore Minot në Dakotën Veriore, avionët bombardues amerikanë B-52 arritën në Evropë në 22 gusht, duke fluturuar

në bazën e Forcës Ajrore “Fairford” të Mbretërinë e Bashkuar.

Që nga viti 2018, SH.B.A. ka kryer më shumë se 200 aksione Task Forcë me Aleatët dhe partnerët. Kohët e fundit, konkretisht në muajin maj të këtij viti, fluturimi me

**“Ngjarja e sotme e trajnimit demonstroi përkushtimin e fuqishëm të Shteteve të Bashkuara për NATO-n dhe solidaritetin e aleatëve në veprim. Ndërsa bombarduesit amerikanë tejkalojnë të gjithë 30 Aleatët e NATO-s në një ditë të vetme, ata po shoqërohen nga avionë luftarakë nga e gjithë Aleanca, duke rritur aftësinë tonë për t’iu përgjigjur së bashku çdo sfidë. Stërvitje si kjo ndihmon për të siguruar dhe përmbushur misionin tonë kryesor: të parandalojmë agresionin, të parandalojmë konfliktin dhe të ruajmë paqen.”**

B-1B Lancer u realizua mbi rajonet Nordike, Balltike dhe Detit të Zi, në muajin qershor u realizua një fluturim mbi Oqeanin Arktik si dhe një fluturim në qershor të policisë ajrore në Maqedoninë Veriore, anëtarë më i ri i NATO-s.

## KOMANDA E FORCËS SË PËRBASHKËT BRUNSSUM (JFCBS)

# Gjeneral-lejtënant Krol, merr detyrën si Komandant i JFCBS

**M**ë 27 gusht 2020 në Brunssum-Hollandë, Komanda e Forcave të Përbashkët Brunssum (JFCBS) ka zhvilluar ceremoninë zyrtare për largimin nga detyra të Shefit të Shtabit (COS), për shkak të daljes në pension, pas 39 vite karriere ushtarake, gjenerallejtënantit francez Hubert de Reviere de Mauny dhe njëkohësisht marrjes së kësaj detyre të rëndësishme nga gjeneral-lejtënant Krzysztof Krol, përfaqësues i ushtrisë polake.

Gjenerallejtënant Krzysztof Krol vjen në këtë detyrë nga Polonia, ku pozicioni i tij i fundit në detyrë ishte Zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Polake.

Në fjalën e tij para largimit, Gjenerallejtënant de Reviere de Mauny foli me shumë dëshirë për kohën e tij si Shef i Shtabit (COS), pasi kjo shënon, jo vetëm fundin e kohës së tij në Brunssum të Hollandës, por edhe përfundimin e



karrierës së tij ushtarake, një karrierë që ka është shtrirë 39 vjet shërbimi ushtarak.

Komandanti i Komandës së Forcave të Përbashkëta Brunssum (JFCBS), gjenerali Jörg Vollmer, falënderoi gjeneral-lejtënant de Reviere de Mauny për përkushtimin dhe arritjet e tij gjatë drejtimit të tij në

JFCBS. Ai përgëzoi punën që ka përfunduar gjatë gjithë kohës së tij si COS dhe inkurajimin e tij pozitiv për të gjithë stafin për të vazhduar mësimin dhe punën si një ekip. I gjithë personeli i JFCBS i uron Gjeneral Lejtënant de Reviere de Mauny një pension të merituar, të gjatë dhe të lumtur.

## FORCA AJRORE PORTUGEZE

# Avionët “Viper” F-16 M, në Bazën Ajrore Malbork-Poloni

Në muajin shtator dhe tetor 2020, Forca Ajrore Portugeze do të vendosë në Bazën Ajrore Malbork-Poloni, një personel prej 95 ushtarakësh dhe katër aeroplanë luftarakë “Viper” F-16M, për të kryer aktivitete stërvitore me Aleatët dhe Partnerët e NATO-s.

Vendosja operationale e Forcave Ajrore Portugeze zhvillohet nën ombrellën e Masave të Sigurimit të NATO-s dhe lejon trajnime të kombinuara me forcat e NATO-s në rajon. Avionët luftëtarë “Viper” F-16 M, do të bashkohen me Aleatët dhe partnerët e tjerë të NATO-s gjatë ushtrimeve duke kontribuar drejtpërdrejt në parimin e ndërveprimit dhe mbrojtjes kolektive të Aleatëve.

Avionët portugezë luftarakë “Viper” F-16 M u vendosën për herë të parë në Malbork vitin e kaluar për tu stërvitur dhe ushtruar me Aleatët dhe Partnerët. Fotografitë tregojnë se ata fluturonin në një formacion me Forcën Ajrore Suedeze JAS-39 “Gripen” në prill 2019.

Avionët luftarakë “Viper” F-16 M janë të aftë të kryejnë misione me shumë role si në ajër ashtu dhe në tokë, ku ofrojnë një fleksibilitet të madh dhe sigurojnë mundësi trajnime të shkallës së parë.

“Ekipi ka filluar vendosjen në 1 shtator dhe avionët tanë do të vijnë në 4 Shtator,” - tha komandanti Portugez i Shkëputjes, Majori Duarte Freitas. “Vipers” F-16M janë të aftë të kryejnë misione me shumë role si në ajër e tokë dhe ofrojnë një fleksibilitet të madh dhe mundësi trajnime të shkallës së parë me miqtë tanë”, shtoi majori Duarte Freitas.







Në bazë të misionit që ka FSK është pajisur me armatim dhe mjete aq sa për të kryer detyrat e veta operacionale. Armatimi i FSK-së do të bëhet mbi planin e ngritjes dhe transformimit dhe në përputhje me misionin e ri që ka për mbrojtjen e vendit. Armatimi do të jetë proces në vazhdimësi krahas ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme.



## AKADEMIA E AVIACIONIT TOKËSOR NË ISPARTA-TURQI

# Diplomohen dy inxhinierë aviacioni për forcat ajrore të FSK

**P**as studimeve efektive në Akademinë e Aviacionit Tokësor në Isparta të Republikës së Turqisë, nënoficerët e FSK-së, Behar Zeqiri dhe Labinot Gashi kanë përfunduar me sukses të lartë studimet themelore të aviacionit duke diplomuar me titullin "Inxhinierë të Fluturimit". Studimet kanë qenë të fokusuar në sistemet e helikopterit UH1-H dhe aeroplanit T182-T si dhe sisteme tjera bashkëkohore të aviacionit tokësor.

Studimet kanë qenë të fokusuar në sistemet e helikopterit UH1-H dhe aeroplanit T182-T si dhe sisteme tjera bashkëkohore të aviacionit tokësor. Pas diplomimit të tre pilotëve, Njësisë ajrore të FSK-së i shtohen edhe këta kadro specialistikë shumë të rëndësishëm në ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të aviacionit të FSK-së. Akademia e Aviacionit Ushtarak është komponentë e Komandës së Trajnimit dhe Doktrinës së Forcave të Armatosura të Turqisë", - thuhet në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.



INTERVISTË E Z. ANTON QUNI, MINISTRI I MBROJTJES I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## Shërbimi i detyrueshëm në koordinim me partnerët ndërkombëtarë

*Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni: "Me zbatimin e këtij plani FSK do të arrijë kapacitetet e plota operacionale me mision të ri dhe do të jetë e gatshme të bashkëveprojë me ushtritë aleate dhe në misione paqëruajtëse"*

**Z**.minister si po ecën procesi i tranzicionit të FSK-së në Ushtri të Kosovës?

Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni: Plani i transformimit të FSK-së është plan i detajuar mirë, duke u realizuar në bazë të dinamikës së planifikuar. Me zbatimin e këtij plani FSK do të arrijë kapacitetet e plota operacionale me mision të ri, dhe do të jetë e gatshme të bashkëveprojë bashkë me ushtritë aleate edhe në misione paqëruajtëse.

**Cilat janë disa nga kapacitetet që duhet të plotësohen?**

E para është rekrutimi i stafit dhe personelit sipas ligjit, që duhet të jenë 5 mijë pjesëtarë aktivë dhe 3 mijë rezervë. Të bëhet armatosja individuale dhe kolektive, të jetë forcë mobilizuese brenda parametrave profesionalë, të ngritët mbi standardet dhe doktrinën e NATO-s dhe të jetë e ndërveprueshme me ushtritë e vendeve që janë anëtare të NATO-s.

**A janë funksionalizuar të gjitha komandat që do t'i ketë FSK-ja?**

Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni: Është duke u punuar në këtë drejtim me intensitet të shtuar. Aktualisht janë funksionale dhe duke vepruar me kapacitet të plotë: Komanda e Forcave Tokësore, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes dhe Komanda e Logjistikës. Në fazën e ngritjes të kapaciteteve është edhe Garda Kombëtare, kurse forcat ajrore janë në fazën fillestare, që nënkupton se është duke u punuar në planifikim, strukturë organizative, ngritje të kuadrit. Është lajm i mirë se tash vetëm kemi pilotët e parë të helikopterëve. Edhe në këtë drejtim do të vazhdohet të punohet sipas planeve të përgatitura dhe të miratuara në kuadër të planit gjithëpërfshirës të transformimit të FSK-së.

**Forca e Sigurisë së Kosovës ka**



**dërguar në shkollim një numër të konsiderueshëm të oficerëve të saj. Sipas jush, a do të mjaftojë kjo, apo do të duhet që ushtria e ardhshme të jetë vetëm profesionale apo të jetë edhe e obligueshme për qytetarët e Kosovës?**

Është e ditur tash se ne kemi kadetë

duke u shkolluar në akademitë më të njohura botërore si SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Turqi, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri etj. Se si do të jetë ushtria e ardhshme e Kosovës, profesionale apo obligueshme, do të varet nga vendimi politik i udhëheqjes shtetërore. Ajo çka është më rëndësi është se ne jemi duke punuar mirë dhe me përkushtim në misionin aktual që kemi dhe me ligjet që janë në fuqi që përcaktojnë qartë misionin e FSK-së.

**Në cilat faza duhet të armatosen Forca Ushtarake, ne e dimë që FSK-ja është forcë e armatosur lehtë?**

Në bazë të misionit që ka FSK është pajisur me armatim dhe mjete aq sa për të kryer detyrat e veta operacionale. Armatimi i FSK-së do të bëhet mbi planin e ngritjes dhe transformimit dhe në përputhje me misionin e ri që ka për mbrojtjen e vendit. Armatimi do të jetë proces në vazhdimësi krahas ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme.

**Ministër si do të ndikojë rishikimi i pozicionit të NATO-s karshi FSK-së pas ndryshimeve ligjore që u bën në Kuvend rreth kapaciteteve dhe mandatit të FSK-së?**

Anëtarësimi në NATO është aspiratë dhe objektiv shtetëror i Kosovës. NATO është në Kosovë dhe me FSK kanë bashkëpunim të mirë. FSK është ngritur nga NATO-ja dhe që nga fillimi është zhvilluar mbi doktrinën e NATO-s. NATO është prezent në

Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-së përmes NALT-it (Ekipi Këshillëdhënës Ndërlidhës i NATO-s) dhe kemi bashkëpunim të mirë dhe intensiv në baza ditore.

**Është folur që shërbimi në FSK të jetë i obligueshëm. Sipas jush, a do të duhet të ishte ushtri e obligueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës apo vetëm profesionistët?**

Ideja e shërbimit ushtarak të obligueshëm është në fazën e këshillimeve dhe ekspertizës, duhet të merret një vendim nga udhëheqja e lartë e shtetit në koordinim me partneret tanë ndërkombëtarë, situatën e sigurisë dhe forcën ekonomike të vendit. Aktualisht ne vazhdojmë me punën në ngritjen dhe profesionalizimin e FSK-së mbi misionin, që ka e që është i përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

**E dimë që pjesëtarët serbë të FSK-së janë duke u përballur me sfida të shumta dhe kërcënime nga Serbia, si qëndron çështja e tyre në FSK-në dhe a është plotësuar numri për minoritetet?**


FSK është e hapur për të gjitha komunitetet pa dallim. Ajo ka një numër të madh të pjesëtarëve të saj nga radhët e komuniteteve që shërbejnë me profesionalizim dhe përkushtim. Ne si Ministri e FSK-së i kushtojmë vazhdimisht vëmendje dhe angazhim të madh integritetit dhe rekrutimit të pjesëtarëve të komuniteteve në FSK, por gjithmonë

duke ruajtur edhe kriterin profesional. Me komunitete të tjera jo serbe nuk ka ndonjë problem. Një problem i theksuar është me komunitetin serb që shërbejnë në FSK dhe që i janë nënshtruar një presioni të vazhdueshëm nga shteti serb. Kjo është shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut, sepse është e drejtë e gjithkujt të zgjedhë profesionin, punësimin dhe perspektivën e vet jetësore. Ne jemi të angazhuar vazhdimisht t'u dalim në ndihmë përmes mekanizmave dhe mundësive që kemi dhe mirëkuptim për problemet që ata kanë.

**Diçka rreth konkursit për rekrutët e rinj të FSK-së?**

Aktualisht është në fazën përmblylëse procesi i rekrutimit të kadetëve të rinj për Qendrën e Studimeve Universitare të FSK-së. Mësimi do të zhvillohet në gjuhën angleze. Në të ardhmen do të jetë e hapur edhe për vendet e regjionit. Në të njëjtën kohë, ne kemi pasur konkurs edhe për zgjedhjen e kadetëve për vendet mike si SHBA, Gjermani, Kroaci, Turqi, Maqedoni. Deri më tani gjithçka ka shkuar mirë. Në të njëjtën kohë është hapur konkursi për rekrutimin e ushtarëve të rinj të FSK-së. Parashohim t'i pranojmë rreth 400 ushtarë të rinj. Sipas informatave, ka pasur një interesim shumë të madh nga të rinjtë duke përfshirë edhe gjininë femërore dhe të rinjtë e komuniteteve pakicë.





“Prej sot është aktiv komanda e Brigadës së Evropës Juglindore (SEE-BRIG) në hapësirat e kazermës në Kumanovë ku është edhe komanda e operacioneve për armatën tonë. Të gjitha përgatitjet janë bërë në kohë dhe kanë përfunduar sipas standardeve më të larta të NATO-s dhe me këtë janë krijuar kushte për 50 oficerë të lartë të shteteve anëtare të NATO-s dhe iniciativës SEEBRIG ku 10 oficerë janë nga armata jonë, ndërsa do t’i plotësojnë detyrat e tyre operative”, - ka thënë kryeministri Oliver Spasovski.



Kazerma “Boro Menkov” në Kumanovë

# Maqedonia e Veriut merr Komandën e Brigadës së Evropës Jug-Lindore 2020-2026

*Selia e SEEBRIG, e cila ndryshon vendndodhjen e saj me rotacion, do të jetë në kazermën “Boro Menkov” në Kumanovë në periudhën 2020-2026*

**K**omanda e Brigadës së Evropës Jug-Lindore (SEE-BRIG) në Republikën e Maqedonisë Veriore, me një ceremoni solemne, organizuan më 26 gusht 2020, në kazermat “Boro Menkov” në Kumanovë, zyrtarisht shënoi fillimin e punës në Republikën e Maqedonisë Veriore. Në ceremoni morën pjesë Presidenti i Republikës së Maqedonisë Veriore, Stevo Pendarovski, Kryeministri Oliver Spasovski, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Lejtnant Vasko Gjucinovski, ambasadorë, zëvendës ministri të mbrojtjes, zëvendës shtabeve të përgjithshme dhe atashe ushtarakë. Pas dorëzimit të postit të Komandantit të SEEBRIG, Presidenti Pendarovski, së bashku me Kryeministrin Oliver Spasovski, ministrja e Mbrojtjes Radmila Sekerinska dhe Kryetari i Komitetit Koordinues të Procesit SEDM, Petro Koci, përuan ndërtesën e rinovuar dhe të pajisur e cila do të jetë selia e Shtabit të Përgjithshëm të Brigadës (SEEBRIG) deri në vitin 2026.



“Prej sot është aktiv komanda e Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG) në hapësirat e kazermës në Kumanovë ku është edhe komanda e operacioneve për armatën tonë. Të gjitha përgatitjet janë bërë në kohë dhe kanë përfunduar sipas standardeve më të larta të NATO-s dhe me këtë janë krijuar kushte për 50 oficerë të lartë të shteteve anëtare të NATO-s dhe iniciativës SEEBRIG ku 10 oficerë janë nga armata jonë, ndërsa do t’i plotësojnë detyrat e tyre

operative”, - ka thënë kryeministri Oliver Spasovski.

Selia e SEEBRIG, e cila ndryshon vendndodhjen e saj me rotacion, do të vendoset në këtë kazermë në periud-

hën 2020-2026, në mënyrë që Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore, përveç pjesëmarrjes së njërive të saj dhe oficerëve të personelit në SEE-BRIG, të ketë mundësinë të tregojë se

si përgjegjës dhe mikpritës i mirë në gjashtë vitet e ardhshme.

Në ceremoninë solemne të drejtuar nga Ministrja e Mbrojtjes Radmila Sekerinska dhe Kryetari aktual i pro-

cesit SEDM, zv/ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Petro Koci, u theksua rëndësia e kësaj nisme për rajonin ballkanik dhe më gjerë. Në këtë ceremoni u bë dorëzimi i detyrës nga komandanti i deritanishëm rumun, gjeneral brigade Tudorica Petrache dhe marrja e detyrës së Komandantit të Brigadës, nga Gjeneral brigade Aristedeis Iliopoulos.

Brigada e Evropës Juglindore është themeluar në vitin 1999, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit Rajonal në Fushën e Mbrojtjes të njohur si Marrëveshja Shumëkombëshe e Paqeruarjes për Evropën Juglindore (IEOM), e nënshkruar në 1998 në Shkup nga Ministrat e Mbrojtjes nga: Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Maqedonia Veriore, Rumania dhe Turqia. Sipas Marrëveshjes për Themelimin e Brigadës, vendndodhja e Komandës SEEBRIG është në baza rrotacioni, dhe pritësit e saj deri kanë qenë: Plovdiv-Bullgari, Constanta-Rmani, Stamboll-Turqi dhe Larissa-Greqi. Komandanti i SEEBRIG caktohet me rotacion midis vendeve pjesëmarrëse për një periudhë tre vjeçare.

## Viti 2020-vit i suksesshëm, anëtarësim në NATO dhe SEEBRIG në Kumanovë

“Kumanova bëhet selia e njëresishme rajonale, Brigadës së Evropës Juglindore dhe në gjashtë vitet e ardhshme, ky do të jetë vendi ku do të jetë e vendosur kjo Brigadë si pjesa kryesore e iniciativës që filloi 22 vjet më parë në Shkup dhe në të cilën si shtet mësuam mësimet e para për zhvillimin e aftësive të përbashkëta mbrojtëse”, - deklaroi Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska. Ministrja Shekerinska tha se 2020 i shtoi vitit i suksesshëm në mbrojtje dhe dha dy arsye për festim-anëtarësimin në NATO dhe zhvendosjen e Komandës SEEBRIG në Kumanovë. Ajo shtoi se në gjashtë vitet e ardhshme kemi mundësinë të tregojmë se mund të jemi nikoqirë funksional, të shkëlqyeshëm dhe shumë bashkëpunues.

“Megjithatë na u desht me shume



kohe te behemi anëtar të Aleancës në krahasim me vendet tjera pjesëmarrëse në SEEBRIG, ne nuk ndaluan të bashkëpunojmë, gjë që ishte një mundësi të përgatitemi më shpejtë për anëtarësimin në NATO. Tani, kur të gjithë anëtarët e kësaj nisme janë edhe anëtarë të NATO-s, do të mund të dëshmojmë edhe në nivel të rajonit tonë, por edhe në kuadër të NATO-s, se jemi aleatë, mirëpo parasegjithash jemi fqinjë të zgjuar dhe

të mirë”, -tha ministrja.

„Nuk është hera e parë që jemi qendra e një iniciative rajonale, por për herë të parë ne jemi qendra dhe nikoqiri i një iniciative kaq të madhe rajonale në të cilën rreth 30 përfaqësues të ushtrive tona fqinje do të punojnë dhe do të jetojnë me familjet e tyre në gjashtë vitet e ardhshme dhe kjo është “Një investim i mirë në rolin tonë të ri si një anëtar i NATO-s.”, - tha ajo.

Kazerma “Kuzman Josifovski-Pitu” në Tetovë


## “Urdhri i Meritës” për Batalionin e 3-të të Këmbëtorisë

Në kazermën “Kuzman Josifovski-Pitu” në Tetovë, më 27 gusht 2020, me një ceremoni ushtarake anëtarët e Batalionit të 3-të të Këmbëtorisë (Divizioni i 3-të të Këmbëtorisë) nga Brigada e 1-të të Këmbëtorisë, me respekt të plotë për rekomandimet dhe masat për mbrojtjen kundër përhapjes të virusit COVID-19, organizuan Ditën e Njesisë.

Në ceremoni morën pjesë Komandanti i Brigadës I të Këmbëtorisë, Kolonel Besnik Emini, me një pjesë të stafit nga Komandanti dhe Shtabi i Brigadës I të Këmbëtorisë dhe komandantët e njësive vartëse. Në fjalën e tij, Kolonel Emini dorezoi uroi “Urdhrit të Meritës” për detyrën e kryer me sukses në trajtimin e pandemisë së virusit “COVID-19”.

Me rastin e ditës së njesisë, Komandanti i Batalionit të 3-të, nënkolonel Izeir Ejupi në fjalimin e tij tha: “Sot shënojmë një ditë tjetër në luftën shekullore dhe aspiratat e shumë brezave për një shtet të lirë dhe të pavarur, dhe ceremonia e sotme është një tjetër mundësi për të kujtuar të paraardhësve tanë të lavdishëm dhe veprave të tyre heroike”, por theksoi edhe sakrificën aktuale dhe gatishmërinë e stafit në kryerjen e detyrave të caktuara siç është ajo për të luftuar pandeminë në rajonin Dibër-Reka për të cilën iu dha “Urdhri i Meritës” e që efektivet janë krenarë. Me rastin e ditës së njesisë për suksesin në punë dhe kryerjen e detyrave të punës, u dhënë masa stimuluese.





“Nuk ka asgjë më të nderuar dhe më fisnike sesa t’i shërbesh një vendi dhe populli. Vokacioni që keni zgjedhur do t’ju mësojë të dashuroni pa rezervë vendin tuaj, të vlerësoni dhe respektoni kulturën dhe traditën e tij dhe të gjitha dallimet që e zbukurojnë atë”, -tha Dakiç, duke shtuar se profesioni do t’i mësojë ata të jenë besnikë, të përkushtuar, të disiplinuar, të përgjegjshëm dhe këmbëngulës.



SHBA, KROACI, GREQI, AUSTRI, ITALI DHE MAQEDONIA E VERIUT

# Kadetë të rinj fillojnë arsimin në akademi prestigjioze

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Maqedonisë së Veriut, Gjeneral Major Dragutin Dakiç, priti kadetët të cilët filluan arsimimin e tyre në fillim të muajit shtator në akademitë ushtarake të huaja në Republikën e Kroacisë, Greqisë, Austrisë, Italisë dhe Maqedonisë Veriore. Këtë vit, 24 të rinj kaluan përzgjedhjen për akademitë prestigjioze, duke përfshirë 5 vajza dhe 19 djem.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm përhëndeti kadetët, u uroi fat në punën e tyre të ardhshme dhe i falënderoi për zgjedhjen e një prej ftesave më të nderuara. “Nuk ka asgjë më të nderuar dhe më fisnike sesa t’i shërbesh një vendi dhe populli. Vokacioni që keni zgjedhur do t’ju mësojë të dashuroni pa rezervë vendin tuaj, të vlerësoni dhe respektoni kulturën dhe traditën e tij dhe të gjitha dallimet që e zbukurojnë atë”, -tha Dakiç, duke shtuar se profesioni do t’i mësojë ata të jenë besnikë, të përkushtuar, të disiplinuar, të përgjegjshëm dhe këmbëngulës.

Ai tha se ushtria e sotme moderne kërkon një ushtar të stërvitur dhe të pajisur, të guximshëm, siç i përshtatet Ushtrisë së Malit të Zi. “Ne po ndërtojmë një Ushtri që do të frymëzohet nga patriotizmi, të pajisur mirë, të trajnuar, të aftë t’i përgjigjen të gjitha sfidave moderne me të cilat përballen jo vetëm Mali i Zi, por edhe i gjithë bota,” -tha Dakiç. Nga 24 kadetët e përzgjedhur këtë vit, dy kanë filluar



arsimin e tyre në Shtetet e Bashkuara, një në Republikën e Austrisë, ndërsa përzgjedhja për akademit në Republikën e Turqisë është duke u zhvilluar. Vëmë re se vitin e kaluar kemi dërguar 10 kadetë në akademitë e huaja, gjë që

flet mjaft për angazhimin tonë, si dhe interesin e të rinjve në atë profesion. Ju kujtojmë gjithashtu se aktualisht ka 33 kadetë në akademi, si dhe 87 kadetë kanë mbaruar studimet për pavarësinë e re të akademisë ushtarake.

## Në kujtim të rënies të tre anëtarëve të Forcave Ajrore

Më 2 shtator 2020, u kujtua përvjetori i nëntë i rënies të tre anëtarëve të Forcave Ajrore të Ushtrisë së Malit të Zi. Me këtë rast, Komandanti i Forcave Ajrore të Ushtrisë së Malit të Zi, Nënkolonel Bojan Blagojević dhe Zëvendës Komandanti i Skuadriljes së Helikopterëve, Kapiteni Nikola Simović, vendosën një kurorë me lule në memorialin në Gjirin Dobrec, ku tre anëtarë të Forcave Ajrore të Ushtrisë së Malit të Zi, Nënkolonel Belhadin Sahbazg, major Ivan Obradovi dhe rreshteri i lartë Vidoje Tomić humbën jetën aksidentalisht.

Anëtarët e familjeve të aviatorëve të vrarë, anëtarë të Ushtrisë së Malit të Zi dhe Ministrisë së Mbrojtjes morën pjesë në kremtimin e përvjetorit të nëntë në Gjirin Dobrec.

Komanda e Forcave Ajrore tha se ata ishin pafundësisht krenarë që ishin në të njëjtën linjë me Belhadin, Ivanin dhe Vidojen. Tre anëtarë të ekuipazhit u vranë gjatë një detyre të rregullt trajnimiti, kur një helikopter Gazelle SA341 goditi një shkëmb 10 metra nga deti, midis plazheve Dobrec dhe Zanjica në gadishullin Lustica.




Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Maqedonisë së Veriut, Gjeneral Major Dragutin Dakiç, bisedoi me Major Vlado Bulajić për dërgimin e tij në komandën shumëkombëshe të NATO-s në Itali, Milano (NRDC-ITA). Major Vlado Bulajić, deri tani mbante detyrën e komandantit të kazermave “13 Korriku” në Nikshiq dhe komandant i Ndërmarrjes së Parë të Këmbësorisë, i cili do të jenë në një mision për dy vjet në komandën shumëkombëshe të NATO-s në Itali, Milano (NRDC-ITA), ku ai do të kryejë detyrat e personelit në kuadër të operacioneve dhe planifikimit.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Maqedonisë së Veriut, Gjeneral Major Dragutin Dakiç i uroi suksese, me shpresën që ai të përfaqësonte Malin e Zi në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të përfitojë njohuri të rëndësishme për punën e tij në të ardhshmen në interes të e armatës ushtarake maqedonase.

## Major Vlado Bulajić dërgohet në komandën e NATO-s në Itali







Falë përpjekjeve tona të vazhdueshme gjatë këtyre pothuajse katër viteve, ne tashmë kemi një rezultat-tendenca për të rritur stafin e ulët të formacioneve me ushtarakë është ndalur. Mund të them me siguri se masat gjithëpërfshirëse të marra për rekrutimin e kandidatëve për shërbimin ushtarak, dhe veçanërisht fushata Bëhu një Ushtar, kanë luajtur një rol pozitiv në rritjen e numrit të kandidatëve. Për më tepër, nuk kujtoj ndonjë rritje të mëparshme të pagave të ushtarakëve për tre vjet rresht me një mesatare prej 10%.



## AKADEMIA USHTARAKE “GS RAKOVSKI”

“**S**ot, edhe një herë, kam nderin t’ju përshëndes me rastin e hapjes së vitit të ri shkollor në shkollën më të vjetër ushtarake në Bullgari. Si bartëse e traditave më të mira në arsimin ushtarak, Akademia ende ndjek besëlidhjen e themeluesve të saj-për të stërvitur ushtarakë dhe civilë me cilësi të shquara udhëheqëse dhe mendim përpara, si dhe për të futur tek ata patriotizëm dhe integritet, përgjegjësi dhe vendosmëri për të shërbyer me besnikëri. dhe me përkushtim për At-dheun”, deklaroi Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov gjatë hapjes së vitit akademik në Akademinë Ushtarake “GS Rakovski”.

Ministri Karakachanov uroi që studentët në Akademi të ishin jo vetëm profesionistë të mirë, por edhe të vendosen si udhëheqës të vërtetë. “Kjo është arsyeja pse në vitin e katërt të mandatit tim unë vë theksin përsëri në leadershipin. Do të na duhet edhe më shumë në të ardhmen, duke pasur parasysh sfidat e mjedisit gjeostrategjik gjithnjë e më kompleks dhe kërkesat në rritje për aftësitë mbrojtëse të vendit”, tha Ministri i Mbrojtjes.

“Unë jam i përkushtuar që kauza e profesionit ushtarak të jetë një nga më autoritaret, prestigjozet dhe më të preferuara. Kjo është arsyeja pse unë mora këtë mandat të vështirë menaxhimi. Sepse unë besoj në të ardhmen e Bullgarisë, në energjinë e të rinjve dhe veçanërisht tek ju - udhëheqësit e ardhshëm. Njerëzit mbeten përbërësi më i rëndësishëm i aftësive. Dhe ky është një fillim kryesor në punën tonë. Ne kemi trashëguar nivele jashtëzakonisht të larta të nën-stafit në forcat e armatosura, veçanërisht në formacionet luftarake dhe të deklaruara nga NATO. Dhe kjo shkatërron drejtpërdrejt aftësinë e forcave të armatosura për të përmbyshur detyrat e tyre kushtetuese dhe ato të mbrojtjes kolektive.

Falë përpjekjeve tona të vazhdueshme gjatë këtyre pothuajse katër viteve, ne tashmë kemi një rezultat-tendenca për të rritur stafin e ulët të formacioneve me ushtarakë është ndalur. Mund të them me siguri se masat gjithëpërfshirëse të marra për rekrutimin e kandidatëve për shërbimin ushtarak, dhe veçanërisht fushata Bëhu një Ushtar, kanë luajtur një rol pozitiv në rritjen e numrit të kandidatëve. Për më tepër, nuk kujtoj ndonjë rritje të mëparshme të pagave të ushtarakëve për tre vjet rresht me një mesatare prej 10%. Në Programin e ri për Zhvillimin e Aftësive Mbrojtëse deri në vitin 2032, ne planifikojmë që të ardhurat e njerëzve në mbrojtje të vazhdojnë të rriten në mënyrë të qëndrueshme”, theksoi Ministri Karakachanov.

Sipas tij, ka ende shumë përpjekje sistematike për të kapërcyer numrin e ulët të stafit në forcat e armatosura. “Këtu nuk duhet të harrojmë rezervën e forcave të armatosura, e cila, për fat të

# Karakachanov: Të ardhurat do të rriten në mënyrë të qëndrueshme

*Ministria e Mbrojtjes ka përgatitur propozime legislative për të përmirësuar kushtet për shërbim në rezervë me një projektligj që ndryshon Ligjin për Rezervën e Forcave të Armatosura*



keq, mbetet nivele mjaft të ulta të personelit. Kjo është arsyeja pse ekipi në Ministrinë e Mbrojtjes përgatiti propozime legislative për të përmirësuar kushtet për shërbim në rezervë me një projektligj që ndryshon Ligjin për Rezervën e Forcave të Armatosura. Në leksionin e tij, Ministri Karakachanov gjithashtu tërhoqi vëmendjen për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes: “Ndërsa qeveritë e mëparshme flisnin vetëm për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes, ky është

tashmë një fakt me ne. Bullgaria ka zbatuar me sukses angazhimin e saj ndaj NATO-s për të rritur investimet në mbrojtje. Nga fillimi i vitit 2018, ne kemi zbatuar me sukses Planin Kombëtar për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes në 2% të PBB-së deri në vitin 2024. Me paradhënien në 2019 të 8 avionëve F-16, shpenzimet e mbrojtjes arritën 3.14% të PBB-së, sipas këtij treguesi tashmë jemi ndër vendet me shpenzime të mbrojtjes mbi 2% të PBB-së.

## Gjeneral lejtant Iliev përshëndet gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos

Në një ceremoni në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut, zëvendës shefi i mbrojtjes general lejtant Dimitër Iliev përshëndeti komandantin e ri të Forcave Shumëkombëshe Paqeruajtëse në Evropën Juglindore, gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos nga Greqia. Ai i përshëndeti atë edhe në emër të ministrit të mbrojtjes të Bullgarisë Krasimir Karakachanov.

Në të shprehet shpresë se komandanti i ri do të punojë për shtimin e rolit të Brigadës së Evropës Juglindore si faktor për sigurinë dhe bashkëpunimin ushtarak në rajon. “Unë jam i bindur që ju do të vazhdoni përpjekjet tuaja për të rritur rolin e Brigadës së Evropës Juglindore si një faktor i rëndësishëm në sigurinë dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak në rajon. Mos ndaloni ruajtjen e shpirtit dhe traditave të brigadës dhe fat të mirë në punën tuaj të përgjegjshme në të ardhmen”, tha zëvendës Shefi i Mbrojtjes, Gjeneral lejtant Dimitar Iliev. Zëvendës Shefi i Mbrojtjes falënderoi Komandantin aktual, Gjeneral Brigade Tudorica Petrake të Rumanisë, për shërbimin e tij të përkushtuar dhe kontributin personal në ngritjen e prestigjit të brigadës në rajon dhe midis organizatave partnere ndërkombëtare.

Ngjarja u prit nga Presidenti Stevo Pendarovski, Kryeministri Oliver Spasovski, Ministrija e Mbrojtjes Radmila Shekerinska dhe Shefi i Shtabit të Ushtrisë Gjeneral Lejtant Vasko Gyurçinovski. Në ceremoni morën pjesë gjithashtu Zëvendës Shefat e Mbrojtjes të Shqipërisë, Greqisë, Rumanisë dhe Republikës së Maqedonisë Veriore, përfaqësues të trupit diplomatik dhe atasheve ushtarakë të akredituar në vendin pritës.



## Betohen 44 ushtarakët e rinj në Brigadën 61 dhe të 2-të të Mekanizuar

Njëzet e gjashtë ushtarakë nga Brigada e 61-të e Mekanizuar u betuan në mënyrë solemne më, 28 gusht. Ritualin e zhvillua përpara Monumentit të Ushtarëve të Rënë në Parkun Rosarium-Kazanlak në prani të kryetarit të qytetit Galina Stoyanova, përfaqësues të autoriteteve lokale dhe shtetërore, organizatave ushtarako-atdhetare, të afërm dhe miq të ushtarakëve. Komandanti i Brigadës 61 të Mekanizuar, Gjeneral Brigade Deyan Deshkov, i përshëndeti ushtarakët me fjalët: “Tani e tutje është detyra juaj të bëni të gjitha përpjekjet në përgatitjen tuaj për të qenë të gatshëm t’i përgjigjeni thirrjes së vendit për paqe dhe mbrojtje katastrofat, krizat dhe katastrofat natyrore. Nga sot do t’i shërbeni Nënë Bullgarisë! Sukses! Mirë se vini në formacionin betejë të Brigadës 61! Ndërsa një ditë me parë, me 27 gusht, 18 ushtarë, të caktuar në formacionet ushtarake të Brigadës së Dytë të Mekanizuar në garnizonet e Yambol, Stara Zagora dhe Haskovo, bënë betimin ushtarak. Ritualin solemn u mbajt në rrethin



ushtarak “Kabile” në qytetin e Yambol. “Jini të vërtetë për fjalët që keni thënë! Unë kam besim se betimet tuaja do t’i ktheni në veprat tuaja”, tha në fjalën e tij komandanti i divizionit 20 të artilerisë vetëlëvizëse, nënkolonel Georgi Georgiev, pasi pranoi procesionin ceremonial. Në emër të ushtarakëve të sapoemëruar, Privat Nikolai Sirakov siguroi se ata do të mbanin me dinjitet përgjegjësinë e lartë që kanë marrë sot dhe do të qëndrojnë përgjithmonë besnikë ndaj detyrës së tyre ushtarake. Mysafirë të veprimtarisë ishin kryetari i Komunës së Yambol Valentin Revanski, përfaqësuesi i Komunës së Tundzha Vladimir Stoev, kryetari i Unionit të oficerëve dhe rreshterëve nga rezerva “Georgi Drazhev” Todor Todorov, të afërm dhe miq të ushtarakëve të sapoemëruar.



# Momentet e fundit të Ali Pashë Tepelenës

NGA AURENC BEBJA

“Le Constitutionnel” ka botuar, të hënën e 25 marsit 1822, në ballinë, një shkrim në lidhje me sqarimin e momenteve të fundit të Ali Pashës nëpërmjet letrave të dëshmitarëve okularë të Janinës, të cilin, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar:

“Ali Pasha ra më 5 shkurt, pas një mbrojtjeje me kokëfortësi prej më shumë se tetëmbëdhjetë muajve. Këtu po ju sjellim një përmbledhje të saktë të shkaqeve që i paraprinë katastrofës së tij, dhe ngjarjeve që e shoqëruan atë. Pas disa rrëfimeve kontradiktore të përhapura këtu në lidhje me këto ngjarjet e fundit, ne kemi marrë disa letra të dëshmitarëve okularë nga Janina, të cilat përputhen plotësisht mbi detajet e dhëna.

Rreth fundit të vjeshtës së kaluar, Thahir-Abbas (Tahir Abazi), një shqiptar mysliman dhe ish-oficer i Ali Pashës, ishte revoltuar me disa nga vëllezërit e tij të tjerë kundër Portës dhe u bashkua me suljotët në favor të zotit të tij. Agjentët e qeverisë lakmitare, dhe e cila, për fat të keq të Greqisë, është vendosur prej disa kohësh në rrethinat e saj, u shqetësuan mjaft për këtë ndryshim të shpejtë dhe të papritur.

Kur më vonë udhëheqësit shqiptarë të popujve myslimanë të Epirit dërguan disa deputetë në kongresin e Argos-it për të bashkuar përfundimisht fatin dhe interesat e tyre me ato të grekëve, këta agjentë u alarmuan aq shumë nga kjo rezolutë sa nuk mund të qëndronin, më gjatë, spektatorë, dhe pa u vonuar, bashkuan përpjekjet e politikës së tyre me armaturat myslimane. Ata arritën kështu të bindnin shqiptarët se projekti i grekëve ishte që të shkatërronin sa më shpejt që të mundnin Ali Pashën, të cilit ata kurrë nuk do t'i falnin bezdisjet e së kaluarës, dhe më pas të shfarosnin popujt shqiptarë, gjendja shpirtërore e të cilëve gjithmonë do t'u shkaktonte atyre hije.

Chouschrid Pasha (Hurshid ose Hurshit), më vete, këshillohej nga njëra anë nga këta agjentë, dhe duke parë nga ana tjetër pamundësinë e nënshtrimit të Ali Pashës me armë, përdori si mjet tradhtinë. Ai bëri disa lëshime ndaj Thahir-Abbas-it (Tahir Abazit) dhe kolegët e tij Hagos-Mouhourdar (Hagos Muhurdar), duke u premtuar atyre në emër të sulltanit se do t'i emëronte, të parin pasha të Janinës dhe të dytin pasha të Delvinës, duke emëruar kështu Omer Vrionin, pasha i këtij qyteti të fundit, në pashallikun e Beratit. Që ata t'i besonin, ai dërgoi nga Kostandinopaja një letër dënimi për Ismail-Pachobey-n (Ismail Pasho beun), pashain e Janinës, dhe Hysen Pashën, pashain e Beratit, të cilëve, të strehuar me sa duket në Selanik, u prenë kokat në Mezovon (Metsovo), një qytet dhjetë vende larg Janinës.

*Sipas gazetës franceze “Le Constitutionnel” ka botuar, të hënën e 25 marsit 1822 referuar dëshmitarëve nga Janina*



Kjo masë pati efektin e saj; Thahir-Abbas-i (Tahir Abazi) vuri re vënien në ekzekutim të premtimeve të serasqerit Chouschrid (Hurshid); dhe, pasi shkëmbeu disa pengje me të, ai arriti në Janinë. Duke qenë ndërmjetës midis turqve dhe ish-zotit (pronarit) të tij për të propozuar një marrëveshje, ai u prit me besim në fortesën e këtij të fundit, dhe pati disa takime me të. Ndërsa Ali Pasha i shtynte propozimet turke, ai përfitoi nga vizitat e tij në kala, dhe mori kontrollin e garnizonit që më parë kishte qenë nën urdhërat e tij, dhe tek i cili kishte ende një vetëbesim të madh; garnizoni kaloi në anë të tij dhe dorëzoi vendin.

Kështjella ra kështu në duart e turqve, Ali Pasha u tërhoq me rreth njëqind e dyzet burra në Esocastron (fortesë e brendshme), ku ai deklaroi se në fund të fundit do të hidhte në erë fortesën me të gjitha thesaret e saj. Turqit, të informuar për vendimin e tij, pas disa bisedimesh, i dërguan një konventë (kontratë) të mbuluar me firmat (nënshkrimet) e të gjithë pashallarëve, bejlerëve dhe oficerëve që gjendeshin në Janinë, dhe në të cilën, ata i betuan atij, mbi profetin, mbi kokën e Sulltanit dhe mbi besimin e tyre si myslimanë sunitë (ortodoksë), një tërheqje të ndershme, gëzimin e pasurisë së tij, dhe të gjithë sigurinë dhe mbrojtjen e Portës së Lartë.

Ali Pasha, duke parë këto nënshkrime të shumta, e la veten të tundohej për një moment. U ra dakord që vendi i tërheqjes së tij të ishte kalaja e Gjyrokastërës. Kështu, pasi la oficerin e tij

më besnik në krye të garnizonit të tij të vogël në fortesë, u nis, më 1 shkurt, bashkë me gjashtë bashkëpunëtorët e tij, për në kalanë e Ile du Lac (Ishullit të Liqenit), e cila ishte ende nën urdhërat e tij.

Atje, ai u ftua nga serasqeri të dorëzonte fortesën para se të nisej për në destinacionin e tij. Ndërsa ish-satrapin hezitonte ende, atij iu dërgua një konventë e dytë, e mbushur me një numër më të madh nënshkrimesh, dhe në të cilën i premtonin të njëjtin besim. Atëherë, ai nxorri nga xhepi një palë tespihe dhe i dërgoi në kalanë e tij. Pas kësaj shenje që kishin rënë dakord, oficeri shqiptar dorëzoi vendin, por kur turqit hynë i prenë kokën.

Në të njëjtën kohë, Hasan Pasha, i shoqëruar nga shpatëmbajtësi i Chouschrid Pashës (Hurshid Pashës), shkoi me 60 burra në ishull dhe i paraqiti Ali Pashës letrën e sulltanit. Kur ky i fundit vuri re se në vend të letërës së faljes që i ishte premtuar, i kishin sjellë atij vetëm një letër dënimi me vdekje, ai kapi një pistoletë: “Dhe ju që shkëlmi betimet tuaja në mënyrë tradhëtare, tha ai, kujtoni se Aliu është një grua?” dhe duke folur kështu, ai qëlloi mbi Hasan Pashën dhe e plagosi. Me një të shtënë të dytë, ai vrau një oficer të pashait. Gjashtë oficerët e tij ndoqën shembullin e tij; ata vranë dymbëdhjetë turq, plagosën disa dhe humbën jetën ndërsa po luftonin. Koka e Ali Pashës u transportua më pas, e shfaqur në portën e kalasë së madhe, gjatë gjithë ditës së 6 shkurtit, dhe të nesërmen u dërgua në Kostandinopojë. I tillë ishte fundi i satrapit shqiptar, i cili u ther, por nuk u mund.

Letrat e fundit nga Janina na tregojnë se Chouschrid Pasha (Hurshid Pasha) u largua nga ky qytet më 13 shkurt me trupat e tij, duke u nisur për në Mezovon (Metsovo); ndoshta për të pushtuar paradat e Pindit, dhe për të favorizuar kalimin e thesareve të Ali Pashait. Ai ia dorëzoi Omer Vrionit komandën e Epirit, i cili është në krye të shqiptarëve.

Të njëjtat letra tregojnë se Chouschrid Pashën (Hurshid Pashën) e kanë larguar nga posti i tij i serasqerit, dhe duhet të shkojë në Kostandinopojë për të dhënë llogari për paratë e Ali Pashës. Nuk do të ishte e pamundur që ai të përjetojë fatin e paraardhësit të tij Pasho Beut, të cilit iu pre koka disa ditë para Ali Pashës, armikut të tij të betuar.

Disa njerëz vlerësojnë thesaret e Aliut të një shume prej 250 milionësh; disa të tjerë nuk mendojnë se arrijnë 100 milionëshin; por disa persona, që pretendojnë se janë më të arsimuar (ditur), sigurojnë që thesaret e tij të mëdha janë gruposur dhe fshehur, dhe se satrapin i mjerueshëm mbante vetëm një pjesë të vogël pranë tij.”

Ali-Pacha a succéda le 27 février, après une défense opiniâtre de plus de dix-huit mois. Voici un exposé exact des causes qui ont précédé sa catastrophe, et des événements qui l'ont accompagnée. Après plusieurs variations contradictoires qu'on a répandues ici sur ses derniers événements, nous avons reçu de quartier de Janina des lettres de témoins oculaires qui s'accordent parfaitement sur les détails.

Vers la fin de l'automne dernier, Thahir-Abbas, Albanais mahométan et ancien officier d'Ali-Pacha, s'était révolté avec quelques-uns de ses anciens frères d'armes contre la Porte, et s'était réuni aux soulètes en faveur de son maître. Les agents d'un gouvernement avide, et qui, pour le malheur de la Grèce, s'est établi depuis quelque temps dans son voisinage, conçurent des inquiétudes assez vives sur ce changement subit et inattendu.

Lorsque plus tard les chefs albanais des populations mahométanes de l'Empire envoyèrent des députés au congrès d'Argos pour réunir d'une manière définitive leur sort et leurs intérêts à ceux des Grecs, ces agents furent tellement alarmés de cette révolution qu'ils ne purent rester plus longtemps spectateurs impassibles, et réouvrirent sans délai les efforts de leur politique aux armées musulmanes. Ils parvinrent ainsi à persuader aux Albanais que le projet des Grecs était de détruire aussitôt, qu'ils le pourraient, Ali-Pacha, auquel ils ne pardonneraient jamais les vexations passées, et d'exterminer ensuite les populations albanaises, dont l'honneur belliqueux leur portait toujours ombrage.

Chouschrid-Pacha, de son côté, conseillé d'une part par ces agents, et voyant de l'autre l'impossibilité de réduire Ali-Pacha par les armes, eut recours à la trahison. Il fit des ouvertures à Thahir-Abbas et à son collègue, Hagos-Mouhourdar, et leur promit au nom du sultan de les nommer, le premier pacha de Janina et le second pacha de Delvina, en élevant Omer-Vrion, pacha de cette dernière ville, au pachalich de Berat. Pour qu'ils eussent plus de foi dans ses promesses, il fit venir de Constantinople un firman de condamnation pour Ismail-Pachobey, pacha de Janina, et Hussein-Pliassa, pacha de Berat, qui, exilés en apparence à Salonique, eurent la tête tranchée à Mezovon, ville située à dix lieues de Janina.

Cette mesure eut son effet; Thahir-Abbas y vit une première exécution des promesses de séraskier Chouschrid; et, après avoir échangé des otages avec lui, il arriva à Janina. Intervenant ensuite entre les Turcs et son ancien maître pour proposer un arrangement, il fut reçu avec confiance dans la forteresse de ce dernier, et eut plusieurs entretiens avec lui. Comme Ali-Pacha repoussait avec méfiance les propositions des Turcs, il profita de ses visites dans la forteresse, et gagna la prison qui avait été autrefois sous ses ordres, et coopéra beaucoup de confiance en sa personne; elle passa de son côté, et rendit la place.

La forteresse étant tombée ainsi au pouvoir des Turcs, Ali-Pacha se retira avec environ cent quarante hommes à l'Esocastro (fort intérieur), où il déclara qu'il s'enfermerait et ferait sauter le fort avec tous ses trésors. Les Turcs, instruits de sa ferme résolution, après plusieurs pourparlers, lui



NGA MICHAEL TANCHUM  
"FOREIGN POLICY"

# Si u bë Mesdheu Lindor, "syri" i një cikloni gjeopolitik?

Në mesin e muajit gusht, luftanijet turke dhe greke "shkëmbyen xixa" mes tyre në Mesdheun Lindor, duke rritur tensionet mes dy vendeve në nivelin më të lartë të 20 viteve të fundit. Kriza kishte nisur disa ditë më parë, kur Turqia dërgoi një anije shpimi, të shoqëruar nga luftanijet turke, për të kërkuar naftë dhe gaz natyror në ujërat pranë ishullit grek Kastelorizo, të cilin Athina e pretendon si territorin e saj detar.

Më shumë se kurrë më parë, ngjarjet e fundit rrezikojnë të përshkallëzohen në një konflikt shumëkombësh. Në një shfaqje të mbështetjes së vendosur ndaj Greqisë dhe kundër Turqisë, Franca dërgoi luftanijet veta në ujërat e kontestuara.

Egjipti dhe Izraeli, që zhvillojnë stërvtitje të rregullta ushtarake me Greqinë, kanë shprehur gjithashtu solidaritetin e tyre me Athinën. Me Francën dhe Egjiptin që janë tashmë në një konflikt të hapur me Turqinë në Libi, vëzhguesit në mbarë botën druhen se çdo përshkallëzim i mëtejshëm i tensioneve në Mesdheun Lindor, mund të degradojë në një krizë të madhe nga Evropa në Lindjen e Mesme.

Po si u bë Mesdheu Lindor "syri" i një "cikloni" gjeopolitik? Për dekada me radhë, mosmarrëveshjet mbi kufirin detar në Mesdhe, kanë qenë çështje lokale, dhe të kufizuara tek pretendimet e sovranitetit, dhe deklaratat dhe kundër-deklaratat midis Qipros, Greqisë dhe Turqisë.

Por, gjatë 5 viteve të fundit, burimet e mëdha në det të hapur të gazit natyror, e kanë shndërruar Mesdheun Lindor në një arenë kryesore strategjike, ku konvergjojnë vijat ndarëse më të mëdha gjeopolitike, që përfshijnë Bashkimin Evropian, dhe rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut.

Italia dhe Franca, kanë luajtur një rol kryesor në nxitjen e këtij ndryshimi, që i ka tendosur edhe më tej marrëdhëniet tashmë të ndërlikuara BE-Turqi. Gjërata nisën të ndryshojnë pas zbulimit në gushtin e vitit 2015 të fushës së madhe të gazit natyror në Zohr, territor detar egjiptian nga ana gjigantit energjetik italian ENI.

Zbulimi i rezervës më të madhe me gaz natyror në Mesdheun Lindor deri më sot, nënkuptonte që rajoni kishte befas një rëndësi të madhe. ENI, që është gjithashtu operatori kryesor në shpimet që po kryen rrotull ishullit të Qipros, nisi të promovojë një plan për të grumbulluar gazin qipriot, egjiptian dhe atë izraelit, dhe të përdorë gazsjellësit në Egjipt për ta sjellë gazin në Evropë me një kosto të arsyeshme.

Por projekti mënjanonte Turqinë dhe infrastrukturën e saj të gazsjellësive, duke u përplasur kështu me

planet e Ankarasë për t'u shndërruar në një fuqi energjetike rajonale. Në vitin 2018, gjiganti energjetik francez "Total", kompania e tretë më e madhe e BE-së sa i përket të ardhurave, i dha një goditje tjetër Turqisë duke hyrë në një partneritet me ENI-in në të gjitha operacionet e kërkimit të gazit në Qipro.

Ky veprim e vendosi Francën në mesin e rezervave më të mëdha energjetike të Mesdheut Lindor. Ndërkohë, Qipro ra zyrtarisht dakord të shfrytëzojë infrastrukturën e Egjiptit për eksportin e gazit. Pasi lëvizjes se Nikozias, Izraeli, që më parë kishte menduar të ndërtonte një gazsjellës nënujor Izrael-Turqi, u tërhoq nga projekti, dhe nënshkroi një kontratë për t'ia shitur gazin e vet Egjiptit.

Turqia e shprehu pakënaqësinë e saj për këto zhvillime, duke u angazhuar në një seri lëvizjesh diplomatike, duke kryer eksplorime dhe shpime në ujërat qipriote, secila e shoqëruar nga luftanijet turke. Ankaraja vazhdon të refuzojë njohjen e kufijve detarë të Qipros, të cilat Turqia mendon se u hartuan në mënyrë të paligjshme në dem të saj.

Në këtë mënyrë, ajo pretendon se po mbron të drejtat e turqve qipriote në gjysmën veriore të ishullit, të cilët kanë mbetur jashtë zhvillimit të rezervave të gazit natyror të Qipros, pavarësisht se janë bashkëpronarët e ligjshëm të burimeve natyrore të ishullit të ndarë.

Pas çdo veprimi të Turqisë, fronti Egjipt-Izrael-Qipro-Greqi fitoi gjithnjë e më shumë mbështetje ushtarake nga Franca, Italia dhe Shtetet e Bashkuara, ku secila ka investime të rëndësishme ekonomike mbi gazin e Mesdheut Lindor.

Për Turqinë, mbështetja e aleatëve të saj të NATO-s ndaj këtij grupimi

është një tradhti, të cilën ajo nuk mund ta tolerojë. Në një përpjekje për të dalë nga izolimi i saj rajonal, Turqia nënshkroi në nëntorin e 2019-ës marrëveshjen e saj të kufirit detar me Qeverinë e Akordit Kombëtar (GNA) me qendër në Tripoli në Libinë e shkatërruar nga lufta.

Marrëveshja ishte një përpjekje për të pasur pozita më të forta ligjore, për të sfiduar kufijtë detarë që Greqia ka hartuar me Qipron dhe Egjiptin, dhe nga të cilat varen planet e tyre në Mesdheun Lindor për nxjerrjen e gazit natyror.

Marrëveshja Ankara-Tripoli u shoqërua me një pakt të bashkëpunimit ushtarak, që i siguroi GNA-së ndihmë kundër përpjekjeve të forcave të gjeneralit Kalifa Haftar, të mbështetur nga Franca dhe Egjipti, për të rrëzuar qeverinë me seli në Tripoli. GNA e aktivizoi zyrtarisht paktin e saj ushtarak me Ankaranë në dhjetorin e vitit të shkuar.

Dhe ndërhyrja e hapur e Ankarasë në konfliktin libian, i jep Ankarasë një platformë prej nga ku ajo mund të sfidojë Qipron, Egjiptin dhe Greqinë mbi kufijtë detarë të Mesdheut Lindor. Duke përfutur nga pozicioni i saj rajonal i sapo-përmirësuar, Turqia u përpoq të promovonte pretendimet e saj ndaj Greqisë, duke dërguar anijen e saj të shpimeve "Oruç Reis", të shoqëruar nga 5 luftanije turke në ujërat e kontestuara pranë Kastelorizo.

Turqia i konsideron veprimet e saj si të bazuara në të drejtën ndërkombëtare. Dhe Ankaraja ka pjesërisht të drejtë, kur pretendon se kufiri detar me Greqinë është i padrejta. Vija bregdetare mesdhetare e Turqisë, është më e gjatë se kufiri SHBA-Meksikë.

Dhe sipas Konventës së Ligjit

të Detit të Kombeve të Bashkuara (UNCLOS), Turqia ka të ngjarë të ketë të drejtë një zonë detare më të madhe nga sa ka aktualisht. Por nga ana tjetër, Turqia nuk pranon të nënshkruajë UNCLOS, çka ia mbyll rrugën çdo lloj rekursi juridik mbi këtë çështje.

Ndërkohë harta e marrëveshjes së kufirit detar Turqi-Libi, përcakton një zonë detare maksimale për Turqinë, duke i mohuar secilit prej ishujve grekë një shelf kontinental ose një Zonë Ekskluzive Ekonomike (EEZ), që siguron të drejtat sovraane mbi burimet energjetike në det të hapur.

Më 6 gusht, Greqia iu përgjigj Turqisë me të njëjtën monedhë, duke nënshkruar një marrëveshje të ngjashme të kufirit detar me Egjiptin. Disa ditë më vonë, anija kërkimore "Oruç Reis" depërtoi brenda kufijve detarë të Greqisë. Po çfarë pritet të ndodhë më tej? Shumica e palëve në rajon kanë shumë arsye, që të angazhohen në uljen e tensioneve, dhe të gjejnë një zgjidhje të shpejtë të krizës. Pavarësisht se e mbështetin Greqinë, as Egjipti dhe as Izraeli nuk mund t'i lejojnë vetes të zhyten në një luftë me Turqinë në Mesdheun Lindor.

BE-ja e ka shprehur mbështetjen e saj të paanshme për anëtarët e unionit, Greqinë dhe Qipron. Por blloku është i përçarë mbi mënyrën se si duhet trajtuar kriza aktuale. Gjashtë vendet mesdhetare të BE-së, janë të ndara në mënyrë të barabartë. Greqia, Qipro dhe Franca mbrojnë një veprim të fortë kundër Turqisë, ndërsa Italia, Malta dhe Spanja – që kanë interesa të mëdha tregtare me Turqinë në Mesdheun Qendror dhe atë Perëndimor – e refuzojnë këtë qasje. Gjermania, që drejton presidencën e BE-së që nga korriku, është ajo që mund të diktojë daljen nga ngërçi. Edhe pse Berlioni i

nënshtrohet zakonisht Parisit kur është fjala për politikën në Mesdhe, ai është i prirur ta mbajë Ankaranë sa më afër BE-së që të jetë e mundur. Turqia po luan aktualisht me zjarrin.

Nëse shkon shumë larg me veprimet e saj agresive, Bashkimi Evropian, ashtu si edhe Shtetet e Bashkuara, do të rreshtohen plotësisht në anën e Greqisë. Vija e kuqe që Turqia nuk mund ta kapërcejë është Kreta, ujërat jugore të së cilës mendohet se përmbajnë sasi të mëdha të naftës ose gazit natyror.

Megjithëse njihen ndërkombëtarisht si ujëra territoriale greke, harta Ankara-Tripoli ia njeht këtë zonë Libisë. Nëse Turqia e dërgon anijen e saj të shpimeve pranë brigjeve jugore të Kretës, atëherë gjithçka mund të ndodhë. Por deri më tani, Turqia nuk e ka kapërcyer këtë vijë të kuqe.

Ankaraja mund ta përdorë mundësinë e eksplorimeve në ujërat rrotull Kretës, si një mjet shantazhi në bisedime. Çdo proces serioz i uljes se tensioneve midis Turqisë dhe Greqisë, kërkon një palë të tretë me ndikim të mjaftueshëm për ta nxitur Ankaranë dhe Athinën të angazhohen në negociata serioze.

Në këtë drejtim, shenjat më shpresëdhënëse për rajonin janë përpjekjet e fundit konstruktive të Shteteve të Bashkuara, për të arritur krijimin e një zone tampon dhe të armëpushimit në Libi. Lidhja qofte edhe e tërthortë midis konflikteve të ndryshme rajonale, krijon hapësirë për një dialog pragmatik mbi kufijtë detarë në Mesdhe.

Ekziston pra mundësia për të dalë edhe nga kriza aktuale. Dhe kjo mundësi do të kërkojë që SHBA-ja, ndoshta në bashkëpunim me Gjermaninë, të veprojnë me aftësi dhe me një angazhim të fortë diplomatik.







## Forcat Speciale në bazat ushtarake "Grafenwoehr" dhe "Hohenfels"- Gjermani

Forcat Speciale shqiptare treguan aftësitë e tyre më të mira krahas 4000 kolegëve aleatë e partnerë nga Shtetet e Bashkuara, Gjeorgjia, Letonia, Lituania, Moldavia, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Ukraina në stërvitjen "Saber Junction 20", në bazat ushtarake "Grafenwoehr" dhe "Hohenfels" në Gjermani.

